



safejournalists.net

# KOSOVË

## Treguesit e nivelit të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve 2021





**KOSOVË**  
**Treguesit e nivelit**  
**të lirisë së medias**  
**dhe sigurisë së**  
**gazetarëve 2021**

**Autore**  
**Getoarbë Mulliqi Bojaj**

## Titulli origjinal

KOSOVË Treguesit e nivelit të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve 2021

## Publikues

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës  
Prishtina 2022



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës  
Association of Journalists of Kosovo

## Autore

Getoarbë Mulliqi Bojaj

## Lektura

Lingua

## Recensent

Abit Hoxha

## Fotografia e ballinës

Andrija Vukelić

## Dizajni

comma.rs

## Tirazhi

50

Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Fondit Ballkanik për Demokraci, një projekt i Fondit Marshall Gjerman i Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në të nuk pasqyrohen domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze, Fondit Ballkanik për Demokraci, të Fondit Marshall Gjerman të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.



**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

<b>Hyrje</b>	<b>7</b>	B3 Pavarësia editoriale në Transmetuesin e Shërbimeve Publike	21
<b>A Mbrojtja ligjore</b>	<b>9</b>	B4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jo-fitimprurëse	21
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe aplikimi i tyre në praktikë	9	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	22
A2 Efektet e ligjeve kundër shpifjes të gazetarët	12	B6 Pozita ekonomike e gazetarëve	23
A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	14	<b>C Siguria e gazetarëve</b>	<b>24</b>
A4 Liria e punës dhe asociacionit të gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika	15	C1 Statistikat e sigurisë dhe mosndëshkimeve	24
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	16	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe akterëve politikë lidhur me mbrojtjen e gazetarëve	27
A6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informata	17	C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve	28
<b>B Pozita e gazetarëve në redaksi</b>	<b>19</b>	<b>Përfundimet dhe rekomandimet</b>	<b>32</b>
B1 Kufizimet ekonomike ndaj lirisë së gazetarëve	19		
B2 Pavarësia editoriale në mediat private	20		

# Pasqyra dhe fushëveprimi i projektit

Asociacionet e gazetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, me mbështetjen e Komisionit Evropian<sup>1</sup>, kanë themeluar një platformë të përbashkët të quajtur [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) për monitorimin e ndryshimeve në legjislationin dhe praktikën e shteteve të tyre për përfshirje në aktivitete të ndryshme avokuese që kanë për qëllim përmirësimin e mjedisit politik, legjislativ dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe mediat. Duke filluar nga viti 2020, pjesëtarët e platformës e monitorojnë situatën në shtatë vende (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Kosovë<sup>2</sup> dhe Serbi). Çdo vit, vlerësimi i situates realizohet në bazë të metodave të standardizuara për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave<sup>3</sup>, ndërsa fokusi i hulumtimit të avokimit është në ndryshimet në mjedisin e mediave tradicionale dhe elektronike në Ballkanin Perëndimor.

- 
- <sup>1</sup> Në dhjetor të vitit 2019, Komisioni Evropian miratoi projektin trevjeçar [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), me qëllim të fuqizimit të asociacioneve kombëtare të gazetarëve në shtetet e Ballkanit Perëndimor për t'u bërë aktorë të pavarur efektiv dhe llogaridhënës në avokimin e aplikimit të standardeve të BE-së në fushën e lirisë së mediave, me një synim afatgjatë të avancimit të së drejtës së qytetarëve për zgjedhje të informuar. Ky Veprim paraqet një zgjerim të projektit të kaluar (Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Avokimin për Lirinë e Mediave dhe Sigurinë e Gazetarëve), bazuar në njohuritë dhe përvojën e fituar në periudhën 2016-2018. Projekti përkrahët nga Programi i Mediave dhe Shoqërisë Civile 2020-2022, Mbështetja për rrjetet tematike rajonale të organizatave të shoqërisë civile.
  - <sup>2</sup> Ky emër është pa paragjykim për statusin dhe në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe mendimin e Tribunalit për Shpalljen dhe Pavarësinë e Kosovës.
  - <sup>3</sup> Botimi i parë i metodologjisë së hulumtimit për këtë projekt hulumtimi për avokim u zhvillua në vitin 2016 dhe u përmirësua me kalimin e viteve për ta reflektuar situatën në vendet e Ballkanit Perëndimor. Hulumtimi për avokim është hartuar dhe koordinuar nga Snezana Trpevska dhe Igor Micevski, kolegë hulumtues të Institutit të Hulumtimeve mbi Zhvillimet Sociale RESIS nga Maqedonia e Veriu ([www.resis.mk](http://www.resis.mk)).

# Një shënim mbi metodologjinë

Metodologjia e hulumtimit përbëhet nga tri grupe të treguesve të zhvilluar në bazë të një analize sistematike të udhëzimeve të ndryshme të hartuara nga organizatat ndërkombëtare relevante. Me kalimin e viteve, treguesit cilësor të zhvilluar në fillim janë përshtatur për ta adresuar kontekstin e veçantë socio-politik në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe për t'i pasqyruar nevojat dhe interesat specifike të gazetarëve në këto shtatë vende.

Një varg metodash të ndryshme hulumtuese janë përdorur për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për t'iu përgjigjur pyetjeve hulumtuese në lidhje me secilin tregues të veçantë:

- Shqyrtimi i studimeve, analizave, raporteve të hulumtimeve, politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analiza cilësore e dokumenteve ligjore;
- Nxjerrja dhe analizimi i informatave të publikuara në uebfaqet e institucioneve publike dhe organizatave e organeve të tjera;
- Nxjerrja dhe analizimi i komunikatave për shtyp, njoftimeve dhe informatave të tjera të prodhura nga organizatat profesionale;
- Të dhëna dytësore të mbledhura nga asociacionet e gazetarëve;
- Intervista të hollësishme me ekspertë, gazetarë, politikëbërës etj.;
- Grupe fokusi me gazetarë dhe
- Anketa me gazetarë (në disa prej vendeve).

Në nivel kombëtar, asociacionet e gazetarëve nominuan hulumtues kombëtarë për ta bërë mbledhjen e të dhënave dhe për të hartuar raporte narrative, të cilat pastaj u rishikuan nga ekspertë kombëtarë të nominuar dhe nga hulumtues kryesorë. Në Kosovë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës nominoi Getoarbë Mulliqi Bojaj si hulumtues kombëtarë dhe Abit Hoxha si ekspertë i mediave për rishikimin e raportit.

Tabela 1: Treguesit e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

A Mbrojtja ligjore	B Pozita e gazetarëve në dhomën e lajmeve	C Siguria e gazetarëve
A1 Garancitë ligjore për lirinë e medias dhe gazetarëve dhe zbatimin e tyre në praktikë	B1 Kufizimet ekonomike në lirinë e gazetarëve	C1 Statistikat e sigurisë dhe mosndëshkimit
A2 Efektet e ligjit kundër shpifjes tek gazetarët	B2 Pavarësia editoriale në mediat private	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve
A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	B3 Pavarësia editoriale në transmetuesin e shërbimit publik	C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve
A4 Liria e punës dhe asociacionit të gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktikat	B4 Pavarësia editoriale në mediat jo-fitimprurëse	
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informata	B6 Pozita ekonomike e gazetarëve	

Lista me shkurtime:

- KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM)
- IREX – “Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave”
- AGK – Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
- RTK – Radio Televizioni i Kosovës (RTK)
- IKD – Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)
- PKPP – Parimet e Kontabilitetit Përgjithshisht të Pranuara
- KM – Kod i Mirësjelljes (KM)
- KMSHK – Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK)
- KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)
- SMIR – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve (SMIR)
- PK – Policisë së Kosovës ose Prokuroria e Kosovës
- TSHP – Televizioni Shtetror Publik



Kosova është themeluar si republikë unitare parlamentare me një qeveri, legjislaturë unikamerale dhe një sistem të së drejtës civile. Kosova funksionon dhe trajtohet si shtet i pavarur nga një numër i madh shtetesh, edhe pse shtetësia e saj kontestohet nga një pakicë e shteteve anëtare të OKB-së. Kosova është kandidatë e mundshme për anëtarësim në BE dhe e ka nënshkruar një Marrëveshje të Stabilizim Asocimit me BE-në në tetor 2015 që është në fuqi që nga prilli 2016. Kosova ka një demografi të larmishme, ku shqiptarët e Kosovës përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë dhe serbët, boshnjakët, turqit, romët e goranët dhe të tjerët përbëjnë pjesën tjetër të popullsisë.

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në shkurt të vitit 2021, një qeveri e re erdhi në pushtet, me një shumicë të fuqishme parlamentare të paparë më herët. Shumica e re e Kuvendit e miratoi qeverinë e re të udhëhequr nga Albin Kurti në mars të viti 2021.<sup>4</sup> Më 17 tetor 2021, në Kosovë u mbajtën zgjedhjet lokale, nën vëzhgimin e Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i cili do ta nxjerrë një vlerësim pas zgjedhjeve.<sup>5</sup>

Kriza ekonomike në Kosovë e shkaktuar nga pandemia COVID-19 kishte një ndikim zinxhiror në sektorin e mediave. Për shkak të pandemisë, tregu i punës u sfidua edhe më shumë dhe çoi në zhvillim më të dobët ekonomik të Kosovës, pasi që tashmë ek-

---

4 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2021", Strasburg, 2021. i qasur më 11.1.2022. <https://bit.ly/39BlHUs>

5 *Ibid.*

zistonte një zgjerim i ngadalshëm ekonomik dhe rritje e dobët në eksport e përqendruar kryesisht në eksportimin e shërbimeve.

Bazuar në mbulim, shtrirja mediatike e Kosovës përbëhet nga dy nivele: mediat kombëtare dhe mediat rajonale. Sipas Raportit Vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) për vitin 2019,<sup>6</sup> Kosova ka 19 stacione funksionale televizive, 86 radio stacione, 41 operatorë distribuimi dhe 97 ofrues të shërbimeve audio-vizuale mediatike. Në mesin e tyre, janë 13 transmetues televiziv në gjuhën shqipe, duke përfshirë transmetuesin publik, pesë transmetues televiziv në gjuhën serbe dhe një që transmeton në gjuhën turke. Prej 86 radio stacioneve të licencuara, 53 transmetojnë në gjuhën shqipe, duke përfshirë dy radio stacionet publike, 22 në gjuhën serbe, tre në gjuhën boshnjake, dy në gjuhën turke, dy në gjuhën gorane, një në gjuhën rome dhe një radio stacion multi-etnik.

Megjithatë, në vitet e fundit, shtrirja mediatike e Kosovës është pasuruar me media të reja dhe ndryshime në pronësi si dhe ekipe editoriale. ATV u themelua në shkurt të vitit 2021, ndërsa është njoftuar edhe një kanal tjetër televiziv. Gjatë vitit 2021, pati shumë ndryshime në sektorin e medias, ndërkohë që u vërejtë se disa gazetarët vazhdimisht i ndërruan vendet e punës. Konsiderohet që kjo ka të bëjë me faktin se mediat e sapohapura ofrojnë kushte më të mira se ato ekzistuese. Përveç gazetarëve, disa prej organeve kryesore nga mediat (sidomos nga televizioni) e ndryshuan kompaninë mediale. Bashkë-themeluesi dhe drejtori i Gazetës Express dhe T7, Berat Buzhala, i shiti aksionet e tij në të dy kompanitë mediale, ndërsa Leonard Kërquki e mori detyrën e menaxhimit të të dy medimeve.

---

<sup>6</sup> KPM, "Raporti vjetor i punës për vitin 2019", Prishtinë: 2020, i qasur më 15.12.2021, <https://bit.ly/3NuxkLT>

### **A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe aplikimi i tyre në praktikë**

---

**A është e garantuar e drejta për lirinë e shprehjes dhe informimit? A e përfshin edhe qasjen në internet? A zbatohen në praktikë garancitë ligjore?**

---

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e shprehjes, lirinë e informimit, lirinë e së drejtës së mediave për qasje në dokumente publike si dhe të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre për t'i themeluar dhe përdorur mediat e tyre.<sup>7</sup> Këto garanci përfshijnë edhe të drejtën për qasje në internet, edhe pse nuk përmendet në mënyrë të drejtpërdrejt. e drejta për liri të shprehjes mund të kufizohet vetëm me ligj, në rast se është e nevojshme për t'i mbrojtur interesat ligjorë dhe të përgjithshëm: për ta parandaluar nxitjen apo provokimin e dhunës në bazë të urrejtjes racore, kombëtare, etnike apo fetare.<sup>8</sup> Liria e shprehjes është e garantuar edhe me Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes<sup>9</sup> i cili parasheh një ekuilibër në mes të rolit esencial të medias si roje publike dhe të drejtës individuale për reputacion dhe dinjitet. Edhe ligjet e tjera përmbajnë dispozita të hollësishme për zbatimin e garancive kushtetuese dhe

---

<sup>7</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e qasur më 10.1.2022. <https://bit.ly/3sLrwWe>

<sup>8</sup> *Ibid.* Neni 40.

<sup>9</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe fyerjes, i qasur më 25.12.2021. <https://bit.ly/3wFJkTY>

rastet në të cilat ato mund të kufizohen, siç është Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave,<sup>10</sup>Ligji për Qasje në dokumente publike,<sup>11</sup> Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve,<sup>12</sup>Kodi Penal (ndalimi i nxitjes së urrejtjes).<sup>13</sup>Megjithatë, opinion i përgjithshëm është që , edhe pse garancitë janë të formuluar mirë në ligje, në disa fusha zbatimi i tyre është mjaft i dobët. Në raportin e progresit për vitin 2021, Komisioni Evropian theksoi që Kosova ka arritur një nivel të përmirësimit sa i përket lirisë së shprehjes. Kosova përfiton nga një mjedis mediatik i gjallë dhe pluralist, pasi që korniza ligjore është kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Poashtu, transmetuesi publik mbetet i cenuar ndaj ndikimit politik dhe ende mbetet të gjindet një zgjidhje e qëndrueshme për financimin e tij.<sup>14</sup>

### A është hartuar legjislacioni për media përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës në konsultim me asociacionet përkatëse profesionale?

Legjislacioni që i rregullon mediat në Kosovë zakonisht është zhvilluar në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me partnerët e brendshëm e të jashtëm, duke përfshirë asociacionet e gazetarëve profesionistë dhe OJQ-të mediale. Megjithatë, gjatë vitit 2021, në Kuvendin Kombëtar të Kosovës disa nisma u mbajtën prapa dyerve të mbyllura. Përkundër thirrjeve për një proces më transparent të diskutimit publik të nismave ligjore, vetëm dëshmitë anekdotale tregojnë për zhvillimin e këtyre rregulloreve. Në planet për projektligje në vitin 2021 ishte paraparë edhe hartimi i ndryshimeve në Ligjin për KPM.<sup>15</sup>Draft ndryshimet u shtynë për agjendën legjislative të vitit 2022 e cila do të miratohet në shtator të vitit 2022<sup>16</sup>, por deri më tani asnjë draft nuk ka qarkulluar as nuk është diskutuar në publik. Sipas KPM-së, parashihet që direktiva (VMS 2018/1808) e cila përfshin ndryshimet përqendrohet në“norma të veçanta që do të sigurojnë pavarësinë funksionale të institucionit<sup>17</sup>”;pa dhënë më shumë hollësi.

10 Ligji nr. 04/L-044.

11 Ligji nr. 03/L-215.

12 Ligji nr. 04/L-137.

13 Kodi Penal, neni 147.

14 Komisioni Evropian, “Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2021”, Strasburg, 2021, i qasur më 15.12.2021. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021SCO292>

15 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Programi Legjislativ Për Vitin 2021, i qasur më 14.02.2022. [file:///C:/Users/admin/Downloads/Final\\_Programi%20Legjislativ%20p%C3%ABr%20vitin%202021\\_12.05.2021.pdf](file:///C:/Users/admin/Downloads/Final_Programi%20Legjislativ%20p%C3%ABr%20vitin%202021_12.05.2021.pdf)

16 Programi Legjislativ për vitin 2021 u miratua në takimin e 11-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 01/1, të datës 7.5.2021.

17 Granit Musliu, Komisioni i Pavarur për Media – Zëvendës Kryesues, 08.03.2022, komunikim përmes email-it

### A kishte përpjekje nga autoritetet shtetërore për ta vendosur si kusht licencimin ose kushte të tjera të rrepta për themelimin e mediave të shkruara dhe të atyre me bazë në internet? A ka kushte të tjera përveç regjistrimit të biznesit dhe taksave?

Mediat e shkruara të Kosovës ndaluan së shtypuri në vitin 2020, për shkak të izolimit gjatë pandemisë por me sa duket ishte fundi i një epoke. Pothuajse të gjitha gazetatat janë kthyer në gazeta elektronike, duke krijuar vetëm përmbajtje me qasje falas, përveç gazetës Koha Ditore e cila ende punon me qasje me pagesë për anëtarët. Përmbajtja pa pagesë ka mundësuar edhe përdorim të madh të mediave sociale për shpërndarje dhe ulje të cilësisë së raportimit, gjë që sigurisht ka çuar në ngritje të shqetësimeve për rregullim të mëtejshëm nga shteti. Autoritetet shtetërore në Kosovë nuk imponojnë kushte paraprake dhe të rrepta për mediat me bazë në internet për regjistrimin e tyre dhe ende nuk kanë marrë ndonjë nismë serioze për ta bërë këtë përkundër debatit të vazhdueshëm politik për nevojën e rregullimit të përmbajtjes në mediat dhe platformat elektronike. Një nismë e tillë është dënuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës. Aktualisht, monitorimi i vetëm i mediave elektronike bëhet nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës i cili e vëzhgon respektimin e Kodit të Etikës<sup>18</sup>. Mediat operojnë si subjekte afariste të regjistruara në Agjencinë përRegjistrimin e Bizneseve dhe regjistrohen drejtpërdrejtë në Administratën Tatimore të Kosovës.

### A ka pasur përpjekje nga autoritetet shtetërore për ta kufizuar të drejtën e qasjes në internet ose për të kërkuar bllokimin ose filtrimin e përmbajtjes së internetit?

Kosova e ka Ligjin për Komunikimet elektronike i cili i rregullon aktivitetet e komunikimit elektronik bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik. Përkundër kësaj, Kosova nuk mund të bëjë kufizime të mëdha të qasjes në internet për shkak të mungesës së infrastrukturës për ta bërë këtë. Ligji e garanton të drejtën për qasje në shërbime të duhura të komunikimit<sup>19</sup>dhe nuk ka aftësi teknologjike për ta kufizuar të drejtën e qasjes në internet apo për ta bllokuar ose filtruar përmbajtjen e publikuar në internet. Qeveria nuk e ka kufizuar apo ndërprerë qasjen në internet as nuk e ka censuruar përmbajtjen në internet dhe nuk ka raporte të besueshme që qever-

18 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, <https://bit.ly/3a0hNF9>

19 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, <https://bit.ly/3MUxE6C>

ia e ka monitoruar komunikimin privat elektronik pa autorizim të duhur ligjor.<sup>20</sup>

### **A po i kryen autoriteti rregullativ funksionet e veta në mënyrë të pavarur dhe jodiskriminuese? A kryhen licencimet dhe rregulloret e tjera të transmetimit në mënyrë të drejtë dhe neutral?**

Komisioni i Pavarur i Mediave në Kosovë është i themeluar në mënyrë ligjore për të vepruar si autoritet i pavarur rregullativ. IREX, panelistët e Barometrit të Informimit të Pastër besojnë se emërimet e anëtarëve të bordit janë tejet të politizuar, duke iu shërbyer vetëm interesave të partive në pushtet<sup>21</sup> dhe konsiderohet se veprimtaria e tij ende ndikohet nga partitë politike, për faktin se përzgjedhja e organit vendimmarrës bëhet nga partitë politike në parlament, rekrutimet bëhen përmes komisioneve parlamentare dhe procedurat shpesh nuk janë transparente që garantojnë pavarësi.

### **A abuzohet me dispozitat ligjore për marketingun shtetëror në media për ndikim politik mbi politikën e tyre editoriale? A është alokimi i fondeve shtetërore transparent, i drejtë dhe jo-diskriminues? A i publikojnë institucionet shtetërore rregullisht të dhënat për shumën e alokuara për media të ndryshme?**

Bazuar në gjetjet e hulumtimit të AGK-së për avokim për vitin 2021, problem kryesor është mostransparenca e institucioneve në lidhje me shpenzimet që i bëjnë në mediat lokale dhe nacionale. Megjithatë, në vitin 2021 institucionet nuk ofruan asnjë raport mbi shpenzimet financiare për informim publik. Bazuar në raportin e vitit 2019, që përmban përgjigjet e dërguara nga 35 institucione të nivelit lokal dhe qendror, shpenzimet e përgjithshme të mediave ishin 598,917.71 euro.<sup>22</sup> Në raportin e tij të progresit për vitin 2021, Komisioni Evropian vlerësoi se në Kosovë ende mungojnë të dhënat për tregun e marketingut, financimi mbetet në masë të madhe jotransparent dhe nuk ka sistem të vlerësimit të audiences.<sup>23</sup>

Bazuar në gjetjet e hulumtimit, paratë e shtetit shpesh përdoren nga institucionet dhe agjencitë përshpalljen

e vendeve të lira të punës, njoftime për tenderë, apo fushata ndërgjegjësuese në media për migrimin, vaksinimin, etj. Përderisa nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë të qartë mes shpenzimeve të qeverisë në media dhe ndikimit të saj në politikën editoriale, së fundmi ka pasur disa diskutime në media për rreziqet nga ndikimi në rritje i qeverisë. Sipas Raportit të Departamentit të Shtetit për të Drejtën të Njeriut, financimi është i kufizuar pjesërisht për shkak se qeveria ngurroi të paguante marketingun në media që publikojnë materiale kritike të politikave të qeverisë.<sup>24</sup>

### **A ka ndonjë lloj subvencionimi për media ose fonde për prodhimin e përmbajtjes mediatike me interes publik dhe si zbatohen ato në praktikë?**

Në Kosovë nuk ka subvencione për Media për t'i përkrahur mediat publike ose private që nga viti 2011, duke i lënë Organizatat Ndërkombëtare të ofrojnë skema të ndryshme të financimit kryesisht përmes aktiviteteve në raportimin e çështjeve ndër-etnike. Sipas përmbledhjes së diskutimit lidhur me Mekanizmat për Financim të Mediave në Gjuhën e Pakicave Etnike të realizuar nga AGK, në mënyrë që kjo rregullore të funksionojë, është e nevojshme që Ligji për Komisionin e Pavarur për Media ta përfshijë një dispozitë që fondet e mbledhura si pjesë e licencimit dhe ndarjes së fondeve të shkojnë për mbështetje financiare të mediave lokale dhe të pakicave.<sup>25</sup> Në një mjedis shumë të paqëndrueshëm politik në Kosovë, konsiderohet jo e dobishme që të ketë çfarëdo financimi nga shteti për ta ndihmuar funksionimin e mediave, pasi që do t'i bënte të cenueshme ndaj ndërhyrjeve politike që mund të vijnë nga personat në pushtet.<sup>26</sup> Megjithatë, shumë media po kalojnë nëpër një kohë të vështirë, gjë që rezultoi në mbylljen e të gjitha mediave të shkruara në vend. Mediat lokale, sidomos ato në gjuhët e pakicave e kanë të vështirë të funksionojnë dhe për këtë arsye duam të punojmë Komisionin e Pavarur për Media që të zbatohet një vendim i marrë para rreth 10 vitesh, sipas të cilit tatimi për licencimin e mediave do të ndahej si financim për mediat lokale. Për këtë nevojiten disa ndryshime në ligjin aktual dhe për këtë arsye po bëjmë përpjekje me deputetët nga të gjitha partitë politike për ta realizuar këtë.<sup>27</sup>

20 Raport mbi Vendin lidhur me praktikimin e të drejtave të njeriut për vitin 2021, Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti i Të Drejtave të Njeriut Për Kosovën 2021, i qasur më 13.4.2022. <https://bit.ly/38QHcRa>

21 IREX, "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3z3cH5t>

22 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, "Raport mbi shpenzimet financiare të institucioneve për informim publik", i qasur më 20.12.2021. <https://bit.ly/3MVJ75M>

23 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2021", Strasburg: 2021, i qasur më 11.01.2022. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021SC0292>

24 Raport mbi Vendin lidhur me praktikimin e të drejtave të njeriut për vitin 2021, Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti i Të Drejtave të Njeriut Për Kosovën 2021, i qasur më 13.04.2022. <https://bit.ly/3MUPp5P>

25 Mekanizmat për Financimin e Mediave në Gjuhët e Pakicave Etnike i qasur më 12.04.2022 <https://bit.ly/3IMUnp5>

26 Intervistë me Xhemaj Rexhën, Kryetar i Bordit të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, intervistë e realizuar nga Getoarë Mulliqaj Bojaj, 12.04.2022.

27 Ibid

## Cilët janë mekanizmat për financimin e mediave në gjuhët e pakicave etnike?

Nuk ka mekanizma të veçantë për financim ose mbështetje financiare të mediave private ose jofitim-prurëse që publikojnë përmbajtje në gjuhët e pakicave të ndryshme etnike. Përkundër kësaj, institucionet e Kosovës kanë shënuar progres në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve joshumicë<sup>28</sup> sipas Misionit të BE-së në Kosovë megjithëse, rekomandimet nga Rezoluta e Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës në Kosovë nga korriku i gushtit 2019 ende mbeten të vlefshme për fushat tjera.

Të gjitha mediat e tjera private, duke përfshirë ato të pakicave etnike, që janë të regjistruara si biznese, duhet t'i sigurojnë vetë të ardhurat e tyre. Shumica e mediave në gjuhën serbe janë të regjistruara si organizata jofitim-prurëse, ndërsa donatorët ndërkombëtarë dhe vendorë iu ofrojnë fondet e tyre operative.<sup>29</sup> Kjo është mbështetur edhe nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës në një përpjekje të përbashkët me Këshillin e Evropës<sup>30</sup> ku AGK-ja shprehu qartë nevojën për mekanizma financues për mediat e pakicave në Kosovë, përveç programit të transmetuesit publik që përfshin program në gjuhën serbe, turke, rome dhe boshnjake.

TSHP (RTK) është i detyruar ligjërisht të ndajë 10% të buxhetit të tij të përgjithshëm të marrë nga të gjitha burimet për kanalën në gjuhën serbe. RTK do të vazhdojë të ndajë 10% të buxhetit të tij të përgjithshëm për kanalën e dytë të RTK-së në gjuhën serbe pas ndërprerjes së financimit nga Buxheti i Kosovës dhe Themeluesi.<sup>31</sup> Për më tepër, shtrirja e mediave përfshin të gjitha komunitetet dhe përfaqëson përbërjen etnike të popullsisë kosovare. Përveç mediave shqiptare, Kosova ka rreth 40 media që transmetojnë/publikojnë përmbajtje në gjuhën serbe, turke, boshnjake ose rome. Grupet specifike, siç janë komunitetet fetare, i kanë poashtu radiot dhe kanalet e tyre televizive.<sup>32</sup>

## A garantohet dhe mbrohet në mënyrë efikase autonomia dhe pavarësia e TSHP? A e garanton korniza e financimit pavarësinë dhe stabilitetin e tij? A është organi mbikëqyrës përfaqësues i shoqërisë në përgjithësi?

Edhe pse autonomia dhe pavarësia e tij është e garantuar me ligj (Nr. 04/L-046)<sup>33</sup> transmetuesi publik Radio Televizioni i Kosovës (RTK) mbetet i ekspozuar ndaj presionit dhe ndikimit politik<sup>34</sup>, pasi që pavarësia e tij editoriale dhe qëndrueshmëria financiare afatgjate dobësohet nga varësia e tij nga financimi i drejtpërdrejt shtetëror, pasi që buxheti i tij përcaktohet çdo vit nga Kuvendi.<sup>35</sup> Prandaj, Komisioni Evropian theksoi që transmetuesi publik mbetet i cenueshëm edhe nga ndikimi politik dhe ende duhet të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për financimin e tij.<sup>36</sup> Organi mbikëqyrës ose Bordi i RTK-së është i themeluar në mënyrë ligjore për ta reflektuar karakterin multi-etnik dhe gjinor të Kosovës.<sup>37</sup> Bordi i RTK-së u shpërbë nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2021, duke e theksuar dështimin e bordit të RTK-së në përbushjen e detyrimeve të tij ligjore dhe financiare.<sup>38</sup> Bordi i ri i RTK-së u zgjodh nga Kuvendi i Kosovës në dhjetor të vitit 2021.

## A2 Efektet e ligjeve kundër shpifjes te gazetarët

### A janë dispozitat e ligjeve kundër shpifjes të rrepta dhe a i mbrojnë ato zyrtarët e shtetit? Cilat janë mangësitë kryesore të këtyre ligjeve?

Ligji Nr. 02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerje<sup>39</sup> ua ndalon autoriteteve publike që të paraqes-

28 OSBE, "Misioni i OSBE-së paraqet vlerësimin e pestë gjithëpërfshirës të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve në Kosovë", <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/493786>

29 IREX, "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave", i qasur më 12.2.2022, <https://bit.ly/3NC3MMf>

30 Mekanizmat për financimin e mediave në gjuhët e pakicave etnike, i qasur më 14.03.2022, <https://bit.ly/3IRdxu0>

31 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Radio Televizionin e Kosovës, i qasur më 22.12.2021, <https://bit.ly/38tM2nu>

32 IREX, "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave", i qasur më 12.02.2022, <https://bit.ly/3MVQRf4>

33 *Ibid.*

34 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2021", Strasburg: 2021, i qasur më 11.01.2022, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021SC0292>

35 *Ibid.*

36 *Ibid.*

37 Neni 25 i Ligjit 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës përcakton që së paku dy (2) anëtarë të Bordit të RTK-së duhet të emërohet nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar duhet të emërohet nga komunitetet tjera jo-shumicë dhe së paku dy (2) anëtarë të gjinisë femërore. Së paku dy (2) anëtarë të Bordit duhet t'i plotësojnë kualifikimet profesionale në financa, menaxhim biznesi dhe çështje ligjore, qasur më 20.12.2020, <https://bit.ly/3t0IOA5>

38 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2021", Strasburg: 2021, i qasur më 12.4.2022, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021SC0292>

39 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr.02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, i qasur më 5.12.2021, <https://bit.ly/3PGzr7D>

in kërkesë për kompensim të dëmit nga shpifja apo fryrja, por zyrtarët publikë mund ta bëjnë këtë vetëm në kapacitetin personal gjë që e krijon një shtresë të hollë të mbrojtjes për gazetarët që të mos paditen për kompensim të dëmit por i inkurajon paditë civile. Rastet e tilla kanë ndodhur përpara dhe me efektivitetin e Gjyqësorit të Kosovës, këto procese mund të zgjasin me vite duke i lënë gazetarët në listë të pritjes për një proces gjyqësor. Ky ligj nuk i mbron nga zyrtarët publikë. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar që deputetët e Kuvendit të Kosovës gëzojnë vetëm imunitet funksional, pra nëse përfshihen në ndonjë akt penal, mund të paditen, d.m.th., mund t'i nënshtrohen vështrimit hulmues dhe kritikave të publikut.

### **Sa padi janë ngritur ndaj gazetarëve nga zyrtarët shtetërorë dhe politikanët gjatë vitit të kaluar?**

Për shkak të faktit se nuk ka bazë të të dhënave për rastet që i përfshijnë gazetarët në mënyrë specifike në gjykata, nuk dihet numri i padive të ngritura kundër gazetarëve nga zyrtarët shtetërorë dhe/ose politikanët. Mbledhja e të dhënave nga institucionet gjyqësore është dashur të finalizohet në fund të gjysmës së parë të vitit 2021, megjithatë nuk është finalizuar ende. Nuk ka të dhëna nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës lidhur me paditë e ngritura ndaj gazetarëve. Megjithatë, në bazë të monitorimit nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) gjatë vitit 2021 u ngritën më shumë se 40 padi dhe u identifikuan mbi 100 padi që janë në proces në gjykata e Kosovës ndaj gazetarëve. Nga raportimi i IKD-së, shumica e këtyre padive janë padi PKPP<sup>40</sup> që janë ngritur për t'i frikësuar aktivistët ambientalistë dhe gazetarët. Në radhë të parë, këto raste nisen nga kompanitë ndërkombëtare dhe kombëtare që punojnë në sektorin e energjisë ujore. Nuk ka bazë të të dhënave të organizuar në nivel institucional as nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës as nga gjykatat sa i përket padive PKPP. Tri raste publike janë kundër aktivistëve Adriatik Gacaferrri, Shpresa Loshaj dhe Agron Demi që janë tërhequr nga paditë pas presionit publik. Megjithatë, edhe pse disa gazetarë dhe media janë paditur me padi PKPP, ata nuk flasin publikisht për shkak të stigmës dhe frikës nga hakmarrja<sup>41</sup>.

### **Deri në çfarë mase janë politikisht të motivuara vendimet e gjykatës kundër disa gazetarëve? Çfarë lloj dënimesh janë shqiptuar?**

Edhe pse gjatë periudhës raportuese nuk është raportuar asnjë shembull konkret i dispozitave ligjore që janë përdorur për t'i heshtur gazetarët, është vënë re që gjërat janë lloji më i zakonshëm i ndëshkimeve që jepen nga disa gjykatës. I njëjti model është përdorur në rastet kur gazetarët janë viktime të akteve kriminale, gjë që krijon një përshtypje që kjo qasje në mënyrë indirekte nxit sulme ndaj gazetarëve.<sup>42</sup> Në Kosovë, legjislacioni në fuqi i dekriminalizon veprat ndaj gazetarëve kur janë duke e kryer punën e tyre, megjithatë ka pasur rritje të rasteve të padive kundër gazetarëve për raportimin e tyre. Rastet e padive ndaj gazetarëve nuk janë publike dhe as mediat as gazetarët nuk flasin publikisht për shkak të frikës së ndikimit të rezultateve të proceseve të tilla gjyqësore. Gazetarët frikësohen se mund të akuzohen për pengim të drejtësisë.

### **A e njohin gjykatat mekanizmin e themeluar vetë-rregullativ (nëse ka)? A e pranojnë validitetin e një përgjigjeje, korrigjimi ose faljeje të publikuar ose të shpërndarë?**

Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes<sup>43</sup> i njez mekanizmat vetë-rregullativë, duke konsideruar zbatueshmërinë e urdhërave apo udhëzimeve nga Këshilli i Mediave të Shkruara apo ndonjë organ përkatës rregullativ, si një rrethanë lehtësuese. Më tutje ai e obligon gjykatën që t'i marrë parasysh masat e ndërmarra nga autori, redaktori apo publikuesi ose dikush që ka ushtruar kontroll mbi përbajtjen e tij në lehtësimin e dëmeve nëse dëshmojnë që kanë kërkuar falje ose kanë ofruar korrigjim para fillimit të veprimit për dëme ose sapo të kenë pasur mundësi.<sup>44</sup> Mekanizmat vetë-rregullativ shërbejnë si instrument për ta ngritur nivelin e profesionalizmit dhe për t'i pajtuar palët që janë të pakënaqura me raportimin e mediave dhe mediat që janë objekt i shkeljeve. Këta

<sup>42</sup> Ibid.

<sup>43</sup> Gazeta Zyrtare, Ligji nr.02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, i qasur më 5.1.2021, <https://bit.ly/3lPRanU>

<sup>44</sup> Në pajtim me Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Neni 12), para parashtrimit të një padie sipas këtij Ligji, një person që pretendohet të jetë i dëmtuar do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të zbutur çdo dëm të shkakuar nga shprehja. Në veçanti, paditësi do të kërkojë përmirësimin e asaj shprehjeje nga personi i cili pretendohet ta ketë shkakuar dëmin. Veprimet e tilla mund ta përfshijnë kërkesën e përmirësimit të shprehjes së supozuar shpifëse apo fyese nga publikuesi dhe paraqitjen e kërkesës para organit kompetent rregullativ sikurse (Komisioni i Pavarur për Media) ose Organi vetë-rregullativ (siç është Këshilli për Mediat e Shkruara).

<sup>40</sup> Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj, Përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi, intervistë e realizuar nga Getoarabë Mulliqaj Bojaj, 15.2.2022.

<sup>41</sup> Flutura Kusari, eksperte e së drejtës së medias, intervista nga Getoarabë Mulliqaj Bojaj 7.03.2022

mekanizma kanë për qëllim të krijojnë disiplinë dhe ta risin performancën profesionale të mediave.<sup>45</sup>

### Çfarë mendojnë gazetarët për ligjin kundër shpifjes? A i dekurajon ky ligj ata që të hetojnë dhe të shkruajnë në mënyrë kritike?

Ligji kundër Shpifjes nuk konsiderohet dekurajues nga gazetarët në realizimin e detyrave të tyre pasi që besojnë se kanë mbrojtje të mjaftueshme sa u përket padive kundër shpifjeve.<sup>46</sup> Megjithatë, gazetarët e konsiderojnë si barrë shtesë për shkak se ligji ndëshkon edhe informatat e pasakta të paqëllimshme gjë që mund të ndikojë në punën e tyre.<sup>47</sup> Përkundër faktit se dhjetëra padi janë ngritur ndaj gazetarëve, gjatë diskutimit në grup fokusi gazetarët deklaruan se kjo nuk ndikon në performancën e tyre, as nuk i frikëson. Supozohet se gazetarët e mediave hulumtuese janë ata që paditen më së shumti.<sup>48</sup>

### **A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media**

#### A është i rregulluar pluralizmi politik në media nga legjislati i mediave jashtë proceseve zgjedhore? Cilat janë detyrimet e TSHP-së dhe ato të transmetuesve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron garanci të përgjithshme për pluralizmin në media (Neni 42)<sup>49</sup> dhe Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave garanton liri dhe pluralizëm të mediave audio-vizuale në Kosovë (Neni 5).<sup>50</sup> Në legjislatin për media (për transmetuesit publik dhe privat) nuk ka dispozita specifike që i obligon ato të reflektojnë pluralizëm politik gjatë periudhës jo zgjedhore, përveç Kodit të Mirësjelljes të KPM-së i cili i obligon transmetuesit e licencuar dhe të gjitha mediat e tjera t'i përmbahen raportimit etik dhe të paanshëm. Sipas përmbledhjes së diskutimit mbi Mbrojtjen Ligjore të Pluralizmit Politik në Media, të realizuar nga

AGK, mund të përfundohet se përkundër rritjes së numrit të mediave në vend, pluralizmi politik në media duhet të ekzistojë gjatë dhe jashtë proceseve zgjedhore, por kjo është e vështirë të arrihet në praktikë; Ekziston një rrezik i koncentrimit të pronësisë së mediave në duart e oligarkëve dhe, rrjedhimisht, një rrezik për krijimin e monopoleve mediale; Konsiderohet se mediat janë të njëanshme ndaj partive politike në qasjen e tyre të gazetarisë ndaj ngjarjeve të ndryshme politike, duke shtuar faktin se mbulimi i fushatave gjatë zgjedhjeve lokale është më i vështirë për shkak të numrit të kandidatëve.<sup>51</sup>

#### A është i detyruar autoriteti rregullativ ta monitorojë dhe ta mbrojë pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore? Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore? Cili organ i monitoron mediat elektronike dhe të shkruara?

Nuk ka obligim specifik për autoritetin rregullativ për ta monitoruar dhe mbrojtur pluralizmin politik në media gjatë periudhës jo zgjedhore.

#### A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media jashtë proceseve zgjedhore?

Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, legjislati sekondar ligjorisht i detyrueshëm i lëshuar nga KPM-ja, përcakton dispozitat për mbulim të balancuar dhe të paanshëm të lajmeve. Megjithatë, KPM e monitoron vetëm përmbajtjen gjatë fushatave zgjedhore, prandaj është e vështirë të vlerësohet nëse mediat në Kosovë reflektojnë pikëpamje të ndryshme politike dhe ide jashtë fushatave elektorale. Sipas përmbledhjes së diskutimit mbi Mbrojtjen Ligjore të Pluralizmit Politik në Media, të realizuar nga AGK, përkundër mungesës së interesimit për informim, KPM vlerëson se përkundër kapaciteteve për monitorim dhe burimeve të tyre të kufizuara, ka pasur mbulim të balancuar dhe të drejtë të të gjithë kandidatëve dhe partive politike në zgjedhje nga mediat<sup>52</sup>, megjithatë KPM e monitoron pluralizmin politik në media vetëm gjatë zgjedhjeve. Poashtu, monitorimi që e bën KPM-ja është monitorim sasior e jo sistematik, pasi që nuk bëhet edhe jashtë fushatave zgjedhore.

45 Ehat Mihtaraj dhe Ylli Zekaj, Përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi, intervista nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 15.02.2022.

46 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

47 Ibid.

48 Ibid.

49 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 42 – Liria e Medias (paragrafi 1), e qasur më 13.12.2021, <https://bit.ly/3a0fwQz>

50 Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, neni 5 – Detyrat dhe përgjegjësitë e KPM-së (paragrafi 3), i qasur më 31.2022, <https://bit.ly/3LMxRH->

51 Përmbledhje e diskutimit për Mbrojtjen Ligjore të Pluralizmit Politik në Media në Kosovë, e qasur më 03.01.2022 <https://bit.ly/3sZcAUu>

52 Përmbledhje e diskutimit për Mbrojtjen Ligjore të Pluralizmit Politik në Media në Kosovë, e qasur më 03.01.2022, <https://bit.ly/3GwCmFd>



## Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore? Cili organ i monitoron mediat elektronike dhe të shkruara?

Obligimi i të gjitha mediave sipas Ligjit Nr. 003/ L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme është të sigurojnë qasje të barabartë dhe t'i përmbahen Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovë,<sup>53</sup> një Kod i Mirësjelljes (KM) i zhvilluar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), që i përcakton të njëjtat standarde etike për të gjitha mediat edhe gjatë periudhës jozgjedhore. Megjithatë, shpesh është raportuar për mospërputhje në mbulim si nga mediat e shkruara ashtu edhe nga ato transmetuese.

Korniza ligjore në Kosovë kërkon që mediat audio-vizuale të ofrojnë qasje të drejtë dhe të paanshme për të gjitha palët, veçanërisht në mbulimin e fushatave zgjedhore.<sup>54</sup> Sipas Ligjit nr. 003/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme (neni 49-53, & 109), KPM-ja ka për obligim ta monitorojë pluralizmin politik përmes qasjes në reklama (falas dhe me pagesë) të ofruara për çdo parti politike nga çdo transmetues, t'i monitorojë shkeljet e obligimeve ligjore, të merret me ankesat dhe t'i japë ndëshkime gjatë periudhës zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi përgjegjës për parashtrimin e kërkesave (duke përfshirë shkeljet e pluralizmit politik) tek KPM-ja.

## A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë fushatave zgjedhore?

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në shkurt të vitit 2021, dhe pas zgjedhjeve lokale në tetor të vitit 2021, monitorimi i zgjedhjeve nga KPM-ja u fokusua në të gjitha format e prezantimit të fushatës zgjedhore në media, siç janë: edicionet e lajmeve, sportet politike, kronikat zgjedhore dhe intervistat dhe debatet e transmetuara nga 16:00 deri në 24:00. Para Zgjedhjeve, bazuar në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, KPM nxjerr Udhëzimet për Zgjedhje përmes të cilave i udhëzon të licencuarit si të sillen gjatë periudhës së zgjedhjeve. Gjatë periudhës së zgjedhjeve lokale, KPM-ja i adresoi katër (4) ankesa<sup>55</sup> ndërsa, gjatë periudhës së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës

së Kosovës asnjë ankesë nuk u parashtrua në KPM.<sup>56</sup> Në përfaqësimin e partive politike në programet e lajmeve në media janë vënë re mospërputhje të vogla, meqë disa partive të caktuara iu jepet kohë e veçantë para se të fillojë zyrtarisht fushata. Konsiderohet që mediat janë të njëanshme drejt partive politike në qasjen e tyre të gazetarisë për zhvillime të ndryshme politike, përkundër faktit se mbulimi i fushatës së zgjedhjeve lokale është më i vështirë për shkak të numrit të kandidatëve. Ka dallime etnike për mbulimin e aktiviteteve politike nga mediat dhe figurat politike që paraqiten në media janë pothuajse të njëjtat dhe nuk ka balancë gjinor.

## **A4 Liria e punës dhe asociacionit të gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika**

### A duhet të licencohen gazetarët nga shteti për të punuar? A ka pasur ndonjë përpjekje gjatë vitit të kaluar për ta prezantuar licencimin?

Shteti nuk parasheh asnjë formë të licencimit për të punuar si gazetar. Liria e punës dhe lëvizjes nuk janë kufizuar për gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave, mirëpo ata duhet t'i mbajnë me vete kartelat e identifikimit të lëshuara nga mediat në cilat punojnë në mënyrë që të mund t'i kryejnë detyrat e tyre. Nuk ka pasur përpjekje nga shteti për ta prezantuar licencimin gjatë viteve të kaluara, siç nuk ka pasur as gjatë periudhës së raportimit.

### A iu është refuzuar gazetarëve e drejta për të raportuar nga ngjarje të caktuara në terren për shkak se nuk kanë qenë të akredituar?

Për shkak të pandemisë COVID-19, vendi u izolua kohë pas kohe prandaj, për t'i kryer punët e tyre, gazetarët duhej të merrnin leje për të vepruar në mënyrë të lirë. Megjithatë, disa gazetarë u penguan gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

53 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, i qasur më 13.01.2022, <https://bit.ly/3wS1qJ>

54 Ligji Nr. 03-L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kapitulli VIII – Mediat gjatë fushatave zgjedhore, f. 24-27, i qasur më 13.01.2022 <https://bit.ly/3MWqW0n>

55 KPM, Raport i monitorimit të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, faqe 6, LOCAL i qasur më 10.01.2022, <https://bit.ly/3GqRrbp>

56 KPM, Raport i monitorimit të ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës për Zgjedhjet e Parakohshme 2021 për Kuvendin e Republikës së Kosovës, f. 14, i qasur më 13.01.2022, <https://bit.ly/3GEmkjh>

**A janë gazetarët të organizuar në asociacione profesionale dhe nëse po si? A bëhen presione mbi organizatën e tyre ose mbi anëtarët individualë?**

Gjatë periudhës së raportimit, ndodhën tri raste të pengimit të gazetarëve gjatë kryerjes së detyrave. Rasti I pare ndodhi në prill të vitit 2021, kur kryeredaktori dhe gazetari i Insajderit, Parim Olluri u morr në pyetje nga Policia e Kosovës, pasi Gazeta Insajderi publikoi një hetim që përmbante informata të brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë.<sup>57</sup> Rasti i dytë ndodhi në nëntor të 2021, kur dy ekipe të televizionit, atij të TV Dukagjinit dhe Klan Kosovës, të cilët shkuan në vendngjarje për të raportuar drejtpërdrejt për një grabitje me armë në rajonin e Prishtinës-Gjilanit u penguan dhe u gjobitën nga Policia e Kosovës; rruga ishte e lejuar për përdorim nga qytetarët e tjerët, por jo nga këto ekipe të TV.<sup>58</sup> Rasti i fundit ndodhi në fund të vitit, kur gazetari dhe redaktori i portalit “Indeksonline”, Alban Muhaxheri u morr në pyetje për disa orë në Stacionin Policor në Kaçanik, pasi kishte shkruar për një anëtar të Policisë në një faqe lokale të Facebook-ut.<sup>59</sup> Megjithatë, nuk ka raste kur gazetarëve iu është refuzuar e drejta për të raportuar nga një ngjarje e caktuar në terren për shkak të mungesës së akreditimit gjatë vitit 2021.

Gazetarët kanë të drejtë për një asociacion dhe janë të lirë të formojnë sindikata siç është garantuar me Kushtetutë, me Ligjin nr. 03/L-212 të Punës<sup>60</sup> dhe me Ligjin nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë<sup>61</sup>. Aktualisht ekzistojnë dy asociacione të gazetarëve të ndara në baza etnike, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) (800 anëtarë) dhe Asociacioni i Gazetarëve Serbë në Kosovë (120 anëtarë). Gjatë vitit 2021, u shënuar një rast i presionit publik ndaj Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës nga Hysamedin Feraj i VV-së, ku ai përdori gjuhë nënçmuese ndaj organizatës, duke e quajtur atë “organizatë e rrezikshme”.<sup>62</sup> Kur AGK reagon në rastet kur shkelen të drejtat e gazetarëve dhe kur është i përfshirë një subjekt politik, presioni mbi AGK-në, duke u akuzuar që është partisan i njëjës apo tjetrës parti politike. Megjithatë, AGK reagon në të gjitha rastet dhe vepron si ndërmjetësues mes gazetarëve dhe institucioneve.

**A janë gazetarët të organizuar në sindikata dhe, nëse po, si? A ka presione ndaj drejtuesve të sindikatave dhe anëtarëve të tjerë? A u jepet gazetarëve liri që të bëhen anëtarë të sindikatave?**

Gazetarët dhe punëtorët medial të transmetuesit publik RTK janë të vetmit të organizuar në sindikata, aktualisht në tre sindikata (Sindikata e Pavarur e RTK-së, Sindikata e Punëtorëve të RTK-së, Sindikata e Punëtorëve të Radios). Nuk ekziston asnjë institucion që funksionon në mënyrë të pavarur për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.<sup>63</sup> Pasi që nuk ka sindikata që i përfaqësojnë interesat e të gjithë gazetarëve në Kosovë, AGK në përgjithësi shërben si pika kryesore e kontaktit për gazetarët në rastet e cenimit të të drejtave të tyre, për referimin e tyre të duhur dhe në disa raste ka vepruar si ndërmjetësues mes gazetarit dhe institucionit.

**A ekziston Këshilli i Mediave të Shkruara dhe si është i organizuar? A ka presione ndaj përfaqësuesve të Këshillit të Mediave?**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) është një organ vetërregullativ që ka filluar punën në vitin 2005 vetëm me gazeta nën juridiksionin e vet. Duke pasur parasysh rritjen e numrit të mediave online, KMSHK ka filluar t'i përfshijë edhe ato. KMSHK është i pavarur nga ndikimet politike pasi që Kuvendi nuk ka ndikim në përzgjedhjen e bordit.<sup>64</sup> Aktualisht, 45 gazeta dhe media online janë anëtare të KMSHK-së.

## **A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve**

**Si garantohet me ligj konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve? Në cilat rrethana mund t'iu nënshtrohet kufizimeve e drejta për t'i mbrojtur burimet e tyre?**

Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve<sup>65</sup> vlen në mënyrë specifike për gazetarët dhe garanton konfidencialitetin të burimeve të tyre dhe është mbështetur me

57 AGK, “Pengim Në Detyrë Kundër Gazetarit, Parim Olluri, i qasur më 13.1.2022, <https://bit.ly/3wSkP7f>

58 AGK, “Pengim Në Detyrë Kundër Ekipit Të Klan Kosovës Dhe Rtv Dukagjinit, Prishtinë”, i qasur më 20.12.2021, <https://bit.ly/3sWhLxe>

59 AGK, “Kërcënim ndaj gazetarit nga polici”, i qasur më 13.1.2022, <https://bit.ly/3LTP81q>

60 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, “Ligji nr. 03/L-212 i punës”, i qasur më 15.1.2022, <https://bit.ly/3LQCBvJ>

61 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, “Ligji nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë”, i qasur më 15.1.2022, <https://bit.ly/3MO70bm>

62 Reporter.net, “Hysamedin Feraj: AGK organizatë e rrezikshme” <https://bit.ly/3wKSc1c>

63 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, “Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë”, Prishtinë: 2014, i qasur më 20.12.2021, <https://bit.ly/3M6LLJb>

64 Imer Mushkolaj, Drejtor i Përgjithshëm i KMSHK-së, intervista nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 25.1.2022.

65 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, “Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve”, i qasur më 12.11.2021, <https://bit.ly/3LRFSev>

Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve,<sup>66</sup> i cili e mbulon çështjen e mbrojtjes së burimit dhe e obligon çdo zyrtar publik t'i mbrojë sinjalizuesit dhe të mos shpërndajë informata për ta tek palët e treta. Ligjet e Kosovës që i mbrojnë sinjalizuesit dhe konfidencialitetin e burimeve janë shumë të mira në letër, por problemi është zbatimi i tyre – zgjidhja e padive për shpifje dhe nxitje të urrejtjes ka zgjatur me shumë vite.<sup>67</sup> Megjithatë, sipas Raportit të Progresit për vitin 2021, Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve është mjaft i avancuar dhe është në përputhje me legjislacionin e ri të BE-së në këtë fushë. Legjislacioni i dytë që e përcakton procedurën për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit hyrë në fuqi në maj të vitit 2021.<sup>68</sup>

**A respektohet konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve nga autoritetet? A ka pasur shembuj kur gazetarët janë urdhëruar që t'i zbulojnë burimet e tyre dhe a është arsyetuar me mbrojtjen e interesit publik?**

Në vitin 2021, nuk kishte raste të gazetarëve që u detyruan t'i zbulonin burimet e tyre. Megjithatë, gjykata mban të drejtën për të kërkuar informata të tilla në raste penale kur jeta e një apo më shumë personave është në kërcënim dhe në rast të një kërcënimi ndaj shtetit.

**A u vunë sanksione kundër gazetarëve që nuk pranuan ta zbulojnë identitetin e një burimi?**

Nuk ka dëshmi të ndëshkimeve të vendosura ndaj gazetarëve gjatë vitit 2021 për zbulimin e identitetit të burimit të informacionit.

**A ndihen të lirë gazetarët që të kërkojnë qasje dhe të mbajnë kontakte me burimet e informacionit?**

Në përgjithësi, gazetarët pohojnë se ndihen të sigurtë për t'i ruajtur lidhjet me burimet e tyre të informacioneve. Megjithatë, disa prej tyre theksojnë që ka raste kur burimet e informacionit nuk ndihen rehat të bashkëpunojnë me gazetarët për tema të caktuara të lajmeve.<sup>69</sup> Kjo është për shkak të besimit të ulët në media dhe narra-

tivës kundër/gazetarëve<sup>70</sup> si dhe për shkak të frikës së hakmarrjes nga spektri politik. Në vitet e fundit, zyrtarët publikë hezitojnë të kenë kontakte dhe të raportojnë në lidhje me keqbërjet ndaj mediave, për shkak të qasjes kufizuese që imponohet nga akterët kryesorë dhe pasojave të tilla si hakmarrja nga mbikëqyrësit e tyre. Institucione si Policia dhe Prokuroria, duke përfshirë disa ministri brenda qeverisë, edhe vetëm duke kuptuar se stafi i tyre ka kontakte me gazetarët, e konsiderojnë sjellje të papërshtatshme të stafit të tyre.<sup>71</sup> Edhe pse Kosova ka miratuar legjislacion shumë të avancuar në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesve dhe dispozita të rrepta që nuk e lejojnë hakmarrjen ndaj sinjalizuesve, bazuar në raportin e Institutit të Kosovës për Drejtësi, legjislacioni i tillë nuk zbatohet siç duhet, ose është në një fazë shumë të hershme të zbatimit të tij.

## **A6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informata**

**Cilat janë rregullat ligjore për qasje në dokumentet dhe informacionet zyrtare që janë të rëndësishme për gazetarët?**

Qasja në dokumente zyrtare është e garantuar me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Qasja në dokumentet publike të prodhuara, të marra, të mbajtura apo të kontrolluara nga institucionet publike si dhe e drejta për ripërdorim të dokumenteve të sektorit publik i garantohet çdo personi, pa dallim në asnjë bazë.<sup>72</sup>

**A i përdorin gazetarët këto rregulla? A i ndjekin autoritetet këto rregulla pa vonesa? A janë autoritetet shtetërore transparente në përgjithësi? A kanë ato marrëdhënie të hapura, jodiskriminuese dhe të drejta me mediat apo kanë tendencë të punojnë në fshehtësi? A i favorizojnë institucionet shtetërore mediat jokritikuese ndaj politikës?**

Sipas Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut për Kosovën, është konstatuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit që institucionet publike nuk kanë kapacitete dhe staf profesional për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje në dokumentet publike, gjë

66 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve", i qasur më 15.10.2020, <https://bit.ly/3GqSNmv>

67 IREX, "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3t33vu2>

68 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2021", Strasburg: 2021, i qasur më 15.12.2021. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52021SC0292>

69 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike, të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

70 Narrativat E Urrejtjes Në Mediat Dhe Komunikimin Elektronik Në Kosovë, f.91, Abit Hoxha & Mirishaha Sylja, i qasur më 25.3.2022. <https://bit.ly/3yY7agp>

71 Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj, Përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi, intervista nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 15.2.2022.

72 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji nr. 06/L-081 për Qasje Në Dokumente Publike, i qasur më 14.1.2022, <https://bit.ly/3NHXzP4>

që shpie ose në vonesa të ndjeshme ose në dështim për të dhënë justifikim ligjor për mohimin ose kufizimin e qasjes.<sup>73</sup> Gazetarët pohojnë se janë të kënaqur me ligjin në fjalë por theksojnë se institucionet nuk janë plotësisht transparente.<sup>74</sup> Prandaj, rekomandojnë avancim të mëtejshëm të mundësisë së publikut për të kërkuar llogari nga Qeveria.<sup>75</sup> Me të gjitha supozimet se mediat janë të ndikuara ose të njëashme sipas gazetarëve, vlerësohet që nuk ka media të cilat trajtohen në mënyrë më favorizuese nga institucionet.<sup>76</sup> Për më tepër, Institucioni i Ombudspersonit ishte në proces të shqyrtimit të 26 ankesave nga mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët individualë lidhur me shkeljet e supozuara të së drejtës për qasje në dokumente publike.<sup>77</sup>

### A janë gjykatat transparente? A sigurohet qasja e mediave në procedurat ligjore mbi një bazë jo-diskriminuese dhe pa kufizime të panevojshme?

Gazetarët kanë qasje në seanca gjyqësore në mënyrë jodiskriminuese, pa asnjë kufizim, përveç rasteve kur një gjykatës jep urdhër për masa mbrojtëse. Megjithatë, në vitet 2019-2020 u bë një përpjekje për ta rishikuar Kodin e Mirësjelljes,<sup>78</sup> gjë që do ta kufizonte mundësinë e gazetarëve për të raportuar nga seancat gjyqësore, duke i detyruar ata të presin deri në vendimin e formës së prerë. Pas shqetësimeve të ngritura nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, kjo përpjekje u pezullua nga KPM-ja.<sup>79</sup> Nuk janë raportuar raste kur gazetarëve nuk iu është dhënë qasje në rastet e hapura gjyqësore në vitin 2022.

### A sigurohet qasja publike në seancat parlamentare? A ka kufizime për gazetarët që e përcjellin punën e Kuvendit?

Gazetarët kanë qasje në Kuvend dhe i mbulojnë seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve. Poashtu, në

Kuvend janë më se 400 gazetarë të akredituar.<sup>80</sup> Brenda sallës plenare, gazetarët mund t'i mbulojnë seancat, ndërsa kameramanët dhe fotoreporterët mund ta bëjnë këtë nga galeria (ballkoni).<sup>81</sup> Sipas gazetarëve që morën pjesë në grupet e fokusit, Parlamenti është institucioni më transparent në Republikën e Kosovës.<sup>82</sup> Puna e Kuvendit është e hapur dhe transparente. Të gjitha seancat e Kuvendit, mbledhjet e komisioneve dhe mbledhjet tjera shpallen paraprakisht në kalendarin e aktiviteteve, në faqen e Kuvendit në internet. Informatat, procesverbalet dhe transkriptat nga seancat plenare të Kuvendit, si dhe të gjitha dokumentet tjera të punës së përditshme publikohen në uebfaqen e Kuvendit.<sup>83</sup> Megjithatë, vizitorëve u kërkohet të regjistrohen në Drejtorinë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun disa ditë para seancës.<sup>84</sup>

### Sa janë të hapur për publikun qeveria dhe ministrinë përkatëse?

Mendimi i përgjithshëm është se qeveria është institucioni më së paku i hapur, për faktin se procesi ose është i zgjatur ose qasja në informacionin e kërkuar nuk jepet fare.<sup>85</sup> Gazetarët hasën vështirësi në marrjen e informacionit nga qeveria dhe institucionet publike, pavarësisht nga ligjet që ofrojnë qasje në dokumente publike.<sup>86</sup> Sipas raportit të fundit të Indeksit të Qëndrueshmërisë së Mediave IREX në Kosovë, zyrtarët qeveritarë kanë zëdhënës ose zyra për informim, por këto zyre ndërlidhëse rrallëherë japin informacione ose marrin pyetje nga shtypi. Çështjet e menjëhershme dhe me rëndësi që kërkojnë përgjigje publike zakonisht adresohen nga zyrtarë publikë, si presidenti ose kryeministri.<sup>87</sup>

73 Raport Vendor mbi Praktikimin e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021, Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti I Të Drejtave Të Njeriut Për Kosovën, i qasur më 13.4.2022. <https://bit.ly/3wRziMC>

74 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarëbë Mulliqaj Bojaj on 10.1.2022 and 11.1.2022.

75 Ibid.

76 Ibid.

77 Raport Vendor mbi Praktikimin e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021, Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti I Të Drejtave Të Njeriut Për Kosovën, i qasur më 13.04.2022. <https://bit.ly/3a08kOz>

78 Komisioni i Pavarur për Media, "KPM-2010/01 Kodi I sjelljes për shërbimet mediale audiovizuale në Republikën e Kosovës", 20.12.2021. <https://bit.ly/3L5FOLv>

79 AGK, "Pas ankesave nga AGK dhe shoqëria civile, KPM e pezullon procesin e ndryshimit të Kodit të Etikës", i qasur më 11.2.2022. <https://bit.ly/3PJiNxz>

80 IKD, "Parlamenti i Kosovës dhe Mediat punojnë për informim më të mirë të publikut", i qasur më 26.12.2021. <https://bit.ly/39UfEdX>

81 Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Roli i medias dhe publikut në punën e Kuvendit", i qasur më 12.02.2022. <https://bit.ly/3z2JfMU>

82 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarëbë Mulliqaj Bojaj on 10.1.2022 and 11.1.2022.

83 Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Roli i medias dhe publikut në punën e Kuvendit", i qasur më 12.2.2022.

84 Ibid.

85 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarëbë Mulliqaj Bojaj on 10.1.2022 and 11.1.2022.

86 Raport mbi Praktikimin e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021, Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti I Të Drejtave Të Njeriut Për Kosovën, i qasur më 13.4.2022. <https://bit.ly/3z4FXqO>

87 IREX, "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3NBt9xN>

**B1 Kufizimet ekonomike ndaj lirisë së gazetarëve**

Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune? A kanë sigurim të duhur social? Sa të larta janë pagat e gazetarëve? A paguhen rregullisht?

Që nga viti 2019<sup>88</sup> Nuk ka të dhëna për numrin e kontratave të nënshkruara në sektorin e medias në Kosovë. AGK e ka theksuar vazhdimisht problemin e çështjeve themelore me të cilat ballafaqohen punonjësit medial në vendin e punës, siç është mungesa e kontratave të punës, duke konsideruar që kjo është shkelje e Ligjit të Punës dhe krijon një gjendje të pasigurë financiare për ta.<sup>89</sup> Gazetarët e Transmetuesit Publik punojnë pa sigurim social që nga viti 2016<sup>90</sup> ashtu si shumica e punonjësve medial në mediat private. Sipas disa gazetarëve nga grupet e fokusit, kohët e fundit disa media private ofrojnë sigurim social, ndërsa disa gazetarë të tjerë nga media të ndryshme e paguan vetë sigurimin social.<sup>91</sup> Sa i përket pagesës, nuk ka të dhëna të sakta për rregullsinë e saj, por konsiderohet se përveç gazetarëve të TSHP, jo të gjithë gazetarët e mediave private paguhen rregullisht. Ka edhe raste kur disa punonjës medial paguhen në para të

88 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, "Gjendja e punëtorëve medial në Republikën e Kosovës", i qasur më 15.2.2022. <https://bit.ly/3aspa7p>

89 AGK, "AGK dhe Inspektorati i Punës me nismë dymujore për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve", accessed 15.2.2022. <https://bit.ly/38XPKU>

90 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarbë Mulliqi Bojaj on 10.1.2022 and 11.1.2022.

91 Ibid.

gatshme. Paga mesatare e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë medial është nën mesataren e vendit.<sup>92</sup>Sipas të dhënave të publikuara në Studimin Bota e Gazetarisë, në Kosovë më pak se gjysma e gazetarëve të punësuar (30 përqind) kanë kontrata të përhershme.<sup>93</sup>

Sipas një studimi të realizuar nga AGK, pandemia i ka prekur më shumë punonjësit medial me paga më të ulëta, sidomos ata që marrin pagë minimale nga 130 deri në 250 Euro. Një numër i konsiderueshëm i punonjësve medial pohuan se ulja e pagave ishte pasojë e reduktimit të detyruar të orarit të punës dhe vështirësive financiare të mediave ku punojnë.<sup>94</sup>

### Cilat janë kushtet e punës në të cilat punojnë gazetarët? Cilat janë problemet më të mëdha me të cilat përballen ata në vendin e punës?

Sfidat kryesore për gazetarët në vendin e punës mbeten mungesa e sigurisë në punë dhe pasiguria financiare të cilat u përkeqësuan në vitin 2020 për shkak të pandemisë. Transmetuesi Publik po ashtu sfidohet me hapësira të vogla të punës, pasi që punojnë në një ndërtesë të marrë me qira nga Qeveria, e cila nuk i përmbush nevojat as kapacitetet e tyre.<sup>95</sup>Sipas diskutimeve në grupe të fokusit, sidomos nga gazetarët e portaleve të lajmeve, numri i lartë i lajmeve është në mesin e sfidave kryesore me të cilat ballafaqohen, si dhe presioni për të publikuar më herët e më shpejt që ndikon negativisht në cilësinë e gazetarisë në sektorin online.<sup>96</sup>Nivelet e pagave janë të rregulluara vetëm në sektorin publik. Në sektorin privat, pagat në Kosovë përcakton në nivel të kompanisë, e jo në mënyrë të centralizuar, në nivel industrie.<sup>97</sup>

## **B2 Pavarësia editoriale në mediat private**

**A kanë miratuar mediat private dokumente organizative sipas të cilave redaksitë mbahen të ndara dhe të pavarura nga menaxherët dhe departamentet e marketingut? A kanë miratuar rregulla të tjera për ta mbrojtur pavarësinë editoriale nga pronarët e mediave dhe organet menaxhuese? A respektohen ato rregulla?**

Disa prej mediave në Republikën e Kosovës kanë miratuar dokumente organizative sipas të cilave redaksitë duhet të mbahen të ndara dhe të pavarura nga menaxherët dhe departamentet e marketingut. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që sektorët e menaxhmentit dhe marketingut nuk ushtrojnë ndikim në përmbajtjen editoriale, pasi që konsiderohet se mediat si biznese janë duke bërë të pamundurën për t'i siguruar të ardhurat e tyre.<sup>98</sup>Megjithatë, sipas Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut, ndërkohë që disa media të vetë-mjaftueshme kanë miratuar politika editoriale dhe transmetuese të pavarura nga interesat politike dhe biznesore, ato me më pak burime ndonjëherë pranojnë mbështetje financiare në këmbim të mbulimit pozitiv ose për t'u përmbajtur nga publikimi i historive negative të dëmshme për interesat e financuesve.<sup>99</sup>

**A kanë redaksitë e mediave private kode të brendshme të etikës ose a i përmbahen ndonjë kodi të përgjithshëm të etikës?**

Mediat private në Kosovë iu përmbahen dy kodeve të brendshme të etikës. Raportimi etik i mediave të shkruara është i rregulluar me Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, që është një Kod i përgjithshëm i Etikës,<sup>100</sup>ndërsa për shërbimet e mediave audio-vizuale është një tjetër dokument vetërregullativ – Kodi i Mirësjelljes për shërbime të mediave audio-vizuale.<sup>101</sup>

92 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), "Niveli i pagës në Kosovë, 2019-2020", i qasur më 5.12.2021. <https://bit.ly/3wYVMOS>

93 Reuters Institute Global Journalism Series e-book "WORLDS OF JOURNALISM Journalistic Cultures Around the Globe"; Redaktorë Thomas Hanitzsch, Folker Hanusch, Jyotika Ramaprasad dhe Arnold S. de Beer, i qasur më 12.02.2022

94 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bajaj on 10.1.2022 and 11.1.2022.

95 Ibid.

96 Ibid.

97 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, "Performanca E Ekonomive Të Ballkanit Perëndimor Lidhur Me Shtyllën Evropiane Të Të Drejtave Sociale 2021 Vlerësim mbi Kosovën", i qasur më 5.2.2022. <https://www.esap-online/download/docs/ESAP-Social-Rights-Pillar-Report-Kosovo.pdf/f72dc00af90c0fbc60354508ce1c3931.pdf>

98 "Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bajaj më 10.01.2022 dhe 11.01.2022.

99 Raport mbi Praktikimin e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021, Departamenti Amerikan i Shtetit, Raporti i Të Drejtave Të Njeriut Për Kosovën, i qasur më 13.4.2022, <https://bit.ly/3Gr2BNf>

100 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, "Kodi i mediave të shkruara për Mediat e Kosovës", i qasur më 13.10.2020, <https://bit.ly/3NGXlr4>

101 KPM, "Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës", i qasur më 13.12.2021, <https://bit.ly/3LMA6uw>

Cilat janë format më të zakonshme të presionit që pronarët dhe menaxherët e mediave e ushtrojnë mbi redaksitë apo gazetarët individualë?

Mungesa e kohës për të bërë hulumtime të plota e të hollësishme për shkak të presionit nga redaktorët dhe menaxhmenti për t'i rritur kuotat ditore është barra më e zakonshme e cekur nga gazetarët.

Në pyetjen për format më të zakonshme të presionit të ushtruar nga pronarët dhe menaxherët e mediave, disa prej gazetarëve që morën pjesë në njërën prej anketave të realizuara nga AGK, pohuan që presion i kohës është më i zakonshmi; presioni për të qenë të parët në publikimin e një ngjarjeje; presioni për të mos mbuluar biznese dhe persona të caktuar; cenzura dhe ndërhyrja gjatë mbulimit të temave të caktuara.<sup>102</sup>

Cili ishte shembulli më ilustrues i presionit të ushtruar nga pronarët e mediave ose menaxherët mbi redaksinë ose mbi ndonjë gazetar individual gjatë vitit të kaluar?

Nuk ka të dhëna për shembuj ilustrues të presionit ndaj gazetarëve gjatë periudhës së raportimit.<sup>103</sup>

### B3 Pavarësia editoriale në Transmetuesin e Shërbimeve Publike

A ka miratuar TSHP-ja kod të sjelljes dhe pavarësisë editoriale të gazetarëve? A e respektojnë gazetarët këtë kod?

Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë së transmetuesit të shërbimeve publike janë të rregulluara me dokumente të brendshme.<sup>104</sup>Në anën tjetër, RTK ka edhe një komision disiplinor që është përgjegjës për trajtimin e çështjeve etike. Është e rëndësishme të theksohet që redaktorët në TSHP pohojnë se Kodi i Etikës respektohet dhe stafi editorial është aty për të siguruar që gazetarët e RTK-së punojnë në përputhje

të plotë me standardet profesionale.<sup>105</sup>Megjithatë, gazetarët theksojnë që janë të informuar për kodin e etikës dhe e respektojnë atë.<sup>106</sup>

Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria i ushtron mbi redaksitë apo gazetarët individë në TSHP?

Gjatë periudhës raportuese nuk është ushtruar presion në redaksi apo gazetarë individë të TSHP-së.<sup>107</sup>Sipas njërit prej grupeve të fokusit, mënyra në të cilën funksionon hierarkia në RTK nuk lë shumë hapësirë për presion të drejtpërdrejt nga Qeveria, megjithatë, mund të ketë raste kur gazetarët hezitojnë të trajtojnë storje nga një këndvështrim i caktuar. Sipas disa gazetarëve, në rast se ka ndonjë presion ato bëhen vetëm ndaj redaktorëve – kryeredaktorëve dhe organeve menaxhuese, megjithatë e njëjta nuk mund të thuhet për gazetarët. Mundësia për presione ndaj RTK-së ka më shumë gjasa të vijë nga partitë politike, përfaqësuesit e të cilave janë në komisione parlamentare të cilat kanë ndikim në ekzekutimin e buxhetit tremujor të RTK-së përmes aprovimit të raporteve të TSHP-së.<sup>108</sup>Për më tepër, gjatë vitit 2021 nuk u raportuan raste të dukshme të presionit qeveritar.<sup>109</sup>

### B4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jo-fitimprurëse

A kanë miratuar mediat jofitimprurëse kod të sjelljes dhe pavarësisë editoriale të gazetarëve? A e respektojnë gazetarët këtë kod?

Sektori i mediave jo-fitimprurëse në Kosovë është më i vogël. BIRN,<sup>110</sup> KOSOVO 2.0<sup>111</sup> dhe Çohu,<sup>112</sup> janë mediat online më të shquara jo-fitimprurëse në Kosovë të cilat kanë zhvilluar kodin e mirësjelljes për gazetarët e tyre. Përveç kodit të etikës, BIRN ka zhvilluar edhe një kod kundër ngacmimit seksual dhe rregullore të tjera të brendshme që e mbulojnë performancën e punon-

102 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

103 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

104 Radio Televizioni i Kosovës, "Standardet profesionale dhe parimet e etikës në gazetari në programet e Radio Televizionit të Kosovës", i qasur më 23.12.2022, <https://bit.ly/3wR5uDM>

105 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

106 Ibid.

107 Ibid.

108 Ibid.

109 Ibid.

110 <https://birn.eu.com/>

111 <https://kosovotwopointzero.com/>

112 <http://www.cohu.org/>

jësve.<sup>113</sup> BIRN Hub<sup>114</sup> i monitoron këto rregullore dhe çdo vit bën një kontrollë të sigurisë dhe vlerësim të kërcënimeve në punë. BIRN ka një statut të organizatës të cilit i përmbahet ky medium jofitimprurës.<sup>115</sup>

**Cilat janë format më të zakonshme të presionit mbi mediat jofitimprurëse? Cili ishte shembulli më ilustrues i presionit të ushtruar mbi mediat jofitimprurëse?**

Gjatë periudhës së raportimit, emisioni televiziv Jeta në Kosovë, i prodhuar nga BIRN u hoq nga organet menaxhuese të TSHP-së. Kontrata u ndërpre pa njoftim paraprak apo ndonjë shpjegim dhe nuk u përtëri asnjëherë.<sup>116</sup> Gjatë vitit 2021 nuk u raportuan raste të tjera të presionit mbi mediat jofitimprurëse.

## **B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve**

**Sa kanë liri gazetarët në përzgjedhjen e lajmeve në të cilat punojnë dhe se cilat aspekte të një storjeje duhet të theksohen?**

Shkalla e lirisë që e kanë gazetarët në përzgjedhjen e storjeve është e kufizuar deri në një masë të caktuar. Siç pohuan shumica e gazetarëve që morën pjesë në diskutime, në përgjithësi, janë të lirë për të sugjeruar një storje. Megjithatë, kur vendoset se nga cila perspektivë do të mbulohej storja, atëherë gazetarët e ndalojnë veten nga të shkruarit kritik, pra, e praktikojnë një shkallë të vetë-cenzurës.<sup>117</sup> Vetë-cenzura manifestohet në mesin e gazetarëve në rastin kur i bashkohen një mediumi të caktuar nën bindjen se po anojnë kah një parti politike. Gazetarët hezitojnë të shkruajnë kundër interesave të pronarëve të mediave apo për partinë e tyre të preferuar politike duke menduar se ka më shumë vetë-cenzurë

se sa cenzurë nga pronarët apo menaxherët për raportimin e lajmeve politike, ekonomike apo edhe sociale.

**Sa shpesh marrin pjesë gazetarët në koordinimin e punëve në redaksi (pjesëmarrja në takime editoriale ose caktimi i reporterëve)?**

Për shkak se gazetarët janë kryesisht ata që sjellin storje në mediat publike dhe private, ata marrin pjesë në koordinimin e redaksisë dhe dhomës së lajmeve. Megjithatë, mediat tradicionale mbajnë mbledhje editoriale në baza ditore, në krahasim me mediat hulumtuese që në disa raste mbajnë mbledhje javore.<sup>118</sup>

**Cilat janë qëndrimet e gazetarëve në lidhje me etikën e gazetarëve?**

Sipas diskutimeve në grupet e fokusit, konsiderohet se gazetarët identifikohen si vëzhgues në distancë.<sup>119</sup> Për shkak të mungesës së kohës për të kryer hulumtime të duhura për shkak të numrit të detyrave që duhet t'i realizojnë, pasi kjo u lë atyre kohë të pamjaftueshme për të bërë hulumtim të duhur, gazetarët pohojnë se kjo iu lë atyre kohë të pamjaftueshme për të bërë hulumtim të duhur që do t'iu mundësonte ta mbulonin një temë në një mënyrë që do ta vendoste rolin e tyre si roje të besueshme dhe kritike të personave në pushtet. Ky është një problem kryesisht për gazetarët e portaleve të lajmeve online. Nga ana tjetër, kjo nuk paraqet problem për gazetarët hetues, pasi që ata kanë më shumë kohë për t'iu qasur siç duhet një ngjarjeje dhe kanë një ndikim më të madh te qytetarët.

**Çfarë janë vetë-perceptimet e gazetarëve lidhur me masën në të cilën janë ndikuar nga rreziqe dhe burime të ndryshme të ndikimit?**

Mund të thuhet që auto-censura është e pranishme, d.m.th. gazetarët e dinë paraprakisht për cilat tema lejohen dhe për të cilat nuk lejohen të raportojnë. Poashtu, në përgjithësi nuk mund të thuhet se nuk ka profesionalizëm ose që gazetarët nuk i dinë rregullat etike dhe profesionale. një numër gazetarësh pohuan se janë të vetëdijshëm për disa tema që nuk mund t'i mbulojnë "... ka disa biznese, performanca e të cilave nuk duhet të mbulohej, dhe e njëjta gjë vlen për disa persona, e gjithë kjo për shkak të politikës editoriale"<sup>120</sup>. Prandaj, gazetari preferon të mos shkruajë për një temë, sesa

113 Intervistë me Kreshnik Gashi, Kryeredaktor në BIRN Kosova, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 15.1.2021.

114 BIRN Hub është një subjekt ombrellë që koordinon punën e Rrjetit BIRN, një aleancë e organizatave vendore joqeveritare që promovon lirinë e fjalës, të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike. Përdorja çdo organizatë vendore adreson nevojat vendore, BIRN Hub, e regjistruar në Bosnjë dhe Hercegovinë, zbaton programe rajonale. <https://bit.ly/3NGXYAW>

115 Kreshnik Gashi, Kryeredaktor në BIRN Kosova, intervista nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 15.01.2021.

116 Intervistë me Kreshnik Gashi, Kryeredaktor në BIRN Kosova, intervista nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 28.2.2022.

117 Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

118 Dygrupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

119 Ibid.

120 Ibid.



të mbulojë temën në mënyrë joprofesionale ose të njëanshme.

Vetë-cenzura konsiderohet si forma më e pranishme e ndikimit që e kanë raportuar të gjithë gazetarët, e jo presioni i drejtpërdrejtë nga organet menaxhuese ose pronarët e mediave. Për disa gazetarë kjo nuk duket të jetë problem, pasi që pohojnë se e kanë ditur që nga fillimi cilat tema mund/do t'i mbulojnë derisa janë pjesë e mediave të caktuara. Gazetarët e vjetër janë kryesisht ata që janë të vetëdijshëm për kufizimet në mbulimin e një teme dhe thjeshtë i respektojnë ato kufizime.<sup>121</sup>

## B6 Pozita ekonomike e gazetarëve

A punojnë gazetarët në kushte më të këqija pune në krahasim me kolegët e tyre meshkuj? A kanë nënshkruar kontrata pune aq shpesh sa burrat?

Në përgjithësi, kushtet e punës të gazetarëve në redaksi nuk janë ndryshe nga ato të gazetarëve. Nuk ka të dhëna lidhur me numrin e grave dhe burrave që kanë nënshkruar kontrata pune, por sipas disa vlerësimeve, në redaksi ka dukshëm më shumë gazetarë.<sup>122</sup>

A priren gratë të mbajnë pozita drejtuese editoriale në redaksi, ashtu si burrat?

Pasi që nuk ka të dhëna të fundit statistikore për pozitat udhëheqëse editoriale në redaksi, besohet se gazetarët janë më të prirura të mbajnë pozita editoriale në redaksi,<sup>123</sup> sidomos në mediat kryesore, ndërsa gazetarët janë më shumë përgjegjës për sektorin menaxherial. Një dallim tjetër është vënë re sa i përket emisioneve kryesore televizive pasi që shumica e tyre udhëhiqen nga meshkuj dhe transmetohen gjatë kohës kryesore. Gazetarët në një nga fokus grupet pohojnë se ky i fundit është duke u përmirësuar dhe kjo ka të bëjë kryesisht me faktin se gratë në redaksi priren të mbulojnë histori më dinamike nga terreni, pra nga pandemia, protestat, kuvendet.<sup>124</sup> Sipas raportit të fundit të Indeksit të Qëndrueshmërisë së Medias IREX Kosova ka mungesë të analistëve dhe komentatoreve për çështje të përditshme.<sup>125</sup>

121 Ibid.

122 Ibid.

123 Ibid.

124 Ibid.

125 IREX, "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3wV19AL>

Sa janë të larta pagat e tyre në krahasim me ato të burrave?

Gazetarët nga grupet e fokusit pohojnë që kontratat nuk janë diskriminuese në aspektin gjinor, pasi që pagat e gazetarëve bazohen në performancën e tyre e jo në gjini dhe pagat e gazetarëve janë të njëjta me ato të kolegëve të tyre burrat.<sup>126</sup>

A i nënshtrohen presioneve specifike me baza gjinore?

Besohet se presioni me baza gjinore është prezent vetëm në rastet kur gazetarët janë shtatzëna dhe/ose pas kthimit në punë pas pushimit të lehonisë. Edhe pse Ligji i Punës iu garanton grave të largohen më herët vitin e parë pasi të kthehen në punë, ato nuk mund ta bëjnë këtë për shkak të natyrës së profesionit të tyre.<sup>127</sup> Sipas disa gazetarëve në grupe të fokusit, punonjësit e TSHP-së nuk përballen me çështjet e lartpërmendura, për faktin se gjithçka që është e rregulluar me ligj, është në fuqi. Megjithatë, besohet se gazetarët janë më të prirura për të marrë ngacmime dhe kërcënime në internet, pasi që shihen si target më i lehtë nga sulmuesit.

126 Dy grupe fokusit me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarë Mulliqaj Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

127 Ibid.



## C1 Statistikat e sigurisë dhe mosndëshkimeve

Bazuar në rastet e raportuara gjatë vitit 2021, siguria e gazetarëve në Republikën e Kosovës ka shënuar disa ndryshime negative në krahasim me vitet e kaluara. Numri i sulmeve fizike dhe kërcënimeve verbale në krahasim me vitin 2020 është rritur për pesë raste, ndërsa në krahasim me vitin 2019, është rritur për tetë raste. Poashtu, sipas Raportuesve pa Kufi, Kosova në vitin 2021 u rendit në vendin e 78-të nga 180 vendet në renditjen botërore,<sup>128</sup> pra u radhit 8 pozita më ulët se vitin e kaluar.

Në katër vitet e fundit, AGK regjistroi 91 raste të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe punëtorëve të tjerë medial, gjithsej 17 raste në vitin 2018, 21 raste në vitin 2019, 24 raste në vitin 2020 dhe 29 raste në vitin 2021. Situata me pandeminë, si dhe ngjarjet politike gjatë periudhës së raportimit ishin faktorët më domethënës që ndikuan negativisht në sigurinë e gazetarëve. Edhe pse numri i shtuar i rasteve të sulmeve është brengosës, fakti që gazetarët janë më të hapur ndaj raportimit të rasteve konsiderohet ndryshim pozitiv. Sa i përket mosndëshkimit të sulmeve, situata mbetet e njëjtë, pasi që në 20 vitet e fundit autoritetet nuk i kanë hetuar në mënyrë të mirëfilltë rastet e gazetarëve të zhdukur dhe të vrarë në vend. Hetimet e policisë kërkojnë kohë dhe siç përshkruhet më poshtë, shumica e rasteve nuk zgjidhen. Për rastet e tjera të sulmeve, kërcënimeve, ngacmimeve dhe formave të tjera të dhunës ndaj gazetarëve, që kanë ndodhur gjatë

<sup>128</sup> Reporterët pa Kufi, "2021 Indeksi i Lirisë së Mediave të Shkruara në Botë", i qasur më 11.2.2022.  
<https://bit.ly/3PGEXkh>

Tabela 2: Numri i kërcënimeve dhe sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve dhe mediave në vitin 2021

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
<p><b>Kërcënimet dhe ngacmimet jofizike</b></p> <p>Kërcënimet dhe ngacmimet jofizike përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– mbikëqyrjen apo përcjelljen;</li> <li>– thirrje telefonike ngacmuese;</li> <li>– ngacmim arbitrar gjyqësor apo administrativ;</li> <li>– deklarata agresive nga zyrtarët publikë;</li> <li>– forma të tjera të presionit që mund ta rrezikojnë sigurinë e gazetarëve në kryerjen e punës së tyre.</li> </ul> <p>Këto lloje të kërcënimeve nuk përfshijnë largimin e dhunshëm nga puna dhe ngacmimin në vendin e punës</p>	13	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Kryetari i Alternativës për Ndryshim, Shqipërim Arifi, përdori gjuhë nënçmuese ndaj korrespondentit të Radio Televizionit të Kosovës në Luginën e Preshevës, Baki Rexhepi</li> <li>– Ekipi i KALLXO.com, gazetarja Arbisa Shefiku dhe kameramani, Denis Sillovinja, u kërcënuan dhe u penguan nga dy persona në Rahovec</li> <li>– Trajneri i futbollit, Tahir Batatina, përdori gjuhë seksiste dhe fyese ndaj gazetares së sportit të RTK-së, Qëndresa Krelani</li> <li>– Drejtori i Gazetës Insajderi, Parim Oullri, u intervistua nga Policia e Kosovës, pasi që Gazeta Insajderi një natë më herët kishte publikuar një hetim që përmbante informata të brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me refuzimin e Vaksinave Pfizer dhe BioNtech nga kjo Ministri</li> <li>– Zyrtarja e Drejtoratit të Arsimit në Komunën e Prishtinës, Anita Xhabiri e ka fyer një gazetar të Gazetës Express, ndërkohë që bashkëshorti i saj e kërcënoi redaksinë pas publikimit të artikullit</li> <li>– Gazetari Mentor Gjergjaj i cili pas një urdhëri të Prokurorisë Themelore në Gjakovë u ftua të paraqitet në Stacionin Policor në Gjakovë për t'u intervistuar</li> <li>– Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përdori qasje selektive ndaj gazetarëve nga Kosova, të cilët ishin pjesë e konferencës për shtyp me Kancelaren Gjermane Angela Merkel</li> <li>– Dega e Lidhjes Demoraktike të Kosovës – LDK, në Suharekë, përdori fjalor linçues ndaj gazetarit, Uran Haxha</li> <li>– Zyrtari i Lëvizjes Vetëvendosje, Hysamedin Feraj, përdori gjuhë kërcënuese ndaj disa gazetarëve</li> <li>– Ekipi i Klan Kosovës dhe RTV Dukagjinit, të cilët shkuan në vendngjarje për të raportuar drejtpërdrejt për grabitje të armatosur në rajonin e Prishtinës-Gjilanit u penguan dhe u gjobitën nga Policia e Kosovës</li> <li>– Grupi në Facebook</li> <li>– me kryeministrin ka vazhduar fushatën njollosëse ndaj gazetarëve</li> <li>– Adriatik Kelemendi – Gazetari nga Kosovo ka raportuar se është marrë në pyetje nga agjentë të Agjencisë Serbe të Informimit (BIA)</li> <li>– Gazetari dhe redaktori i portalit "Indeksonline", Alban Muhaxheri, u morr në pyetje për disa orë në Stacionin Policor në Kaçanik, pasi kishte shkruar për një anëtar të Policisë në një faqe lokale të Facebook</li> </ul>
<p><b>Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve</b></p> <p>Këtu mund të hyjnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– deklarata për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve;</li> <li>– deklarata për dëm fizik ndaj gazetarëve, miqve, familjes apo burimeve të gazetarëve.</li> </ul> <p>Këto kërcënime mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– bërë direct ose përmes palëve të treta;</li> <li>– dërguar përmes komunikimeve elektronike ose ballë për ballë;</li> <li>– mund të jenë implicite si dhe eksplicite.</li> </ul>	10	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Fjalor linçues u përdor ndaj gazetares Albijona Hoxhaj nga zëdhënësi i Kompanisë Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike (KEDS)</li> <li>– Bujar Vitija e Gazetës Shenta u kërcënuan nga një person, që besohet se është babai i një anesteziologu, për të cilin kishte raportuar ky portal</li> <li>– Një person i panjohur përpiqet të hyjë me forcë në zyret e "Botapress"</li> <li>– Ekipi i Kallxo.com u pengua në detyrë dhe u kërcënuan nga tre persona të paignifikuar, të cilët ishin pjesë e stafit të spitalit.</li> <li>– Ekipi i Klan Kosovës u pengua gjatë transmetimit të drejtpërdrejt nga Drenasi</li> <li>– Deputeti Haki Abazi e kërcënoi "Albanian Post"</li> <li>– Këshilltari i Presidentes së Kosovës, Blerim Vela përdori fjalor linçues ndaj mediave</li> <li>– Gazetarët e "Gazetës Sinjali" u kërcënuan me vdekje nga të afërmit e disa personave të arrestuar për organizimin e sulmeve terroriste një ditë më herët</li> <li>– Kryeredaktori i gazetës Bota Sot Idriz Morina dhe familja e tij morrën thirrje telefonike kërcënuese</li> <li>– Vehbi Kajtazi i Paparaci.com mori disa sulme me vdekje në internet</li> </ul>
<p><b>Sulmet fizike ndaj gazetarëve</b></p> <p>Llojet e sulmeve fizike mund të përfshijnë dëmtime fizike ose mendore, rrëmbime, hyrje me dhunë në shtëpi/ zyra, pajisje të sekuestruara, ndalim arbitrar, përpjekje të dështuara për vrasje, et.</p>	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Gazetari Visar Duriqi u sulmua fizikisht në mesnatë në lagjen e tij në shkurt</li> <li>– Gazetarët shqiptarë dhe serbë u sulmuan në Mitrovicën e Veriut</li> <li>– Të njëjtën ditë, gazetarja e Kanalit 10, Albulena Rexha u sulmua me materiale piroteknike gjatë raportimit të drejtpërdrejt nga Mitrovica e Veriut</li> </ul>
<p><b>Vrasjet e gazetarëve</b></p> <p>(në 15-20 vitet e fundit)</p> <p>Llojet e vrasjeve mund të përfshijnë vrasjen në shkëmbim armë zjarri, vrasje, vrasje me shpërthim bombe, rrahje për vdekje, et.</p>	0	
<p><b>Kërcënimet dhe sulmet ndaj organizatave, institucioneve mediale, mediave dhe asociacioneve të gazetarëve</b></p> <p>Sulmet mbi pronën e mediave dhe organizatave, personelin e tyre, grabitje e pajisjeve, deklarata agresive nga zyrtarët publikë, etj. Gjithashtu, kërcënimet dhe sulmet mund të përfshijnë disa nga kategoritë e përmendura më sipër.</p>	3	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Fjalor linçues nga PDK dhe LDK ndaj RTV Dukagjinit gjatë fushatës zgjedhore në janar</li> <li>– Dega e partisë politike Lëvizja Vetëvendosje në Mitrovicë e kërcënoi portalin lokal "Jepi Zë"</li> <li>– Një ekip gazetarësh nga Radio Evropa e Lirë u sulmuan në Mitrovicën e Veriut – kamera dhe taksi u dëmtuan nga një grup prej rreth 50 personash</li> </ul>

vitit 2021 e më parë, vlerësohet se rastet e gazetarëve nuk trajtohen me prioritet nga gjykatat, pasi ato zgjatën ose dënimet e shqiptuara nuk janë në përputhje me ligjin. Megjithatë, Kodi Penal i Kosovës parasheh burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet, në rast të kanosjes apo frikësimit, në rast të dhunës fizike, sipas këtij kodi dënime shkojnë nga 3 muaj deri në 10 vjet burgim. Për më tepër, edhe kur këto raste vijnë në epilog, kryesisht ka të bëjë me një gjobë simbolike, e cila shumë herë është cilësuar nga ekspertët e medias si një shumë që është inkurajuese për autorët për ta përsëritur krimin, për t'i frikësuar dhe sulmuar gazetarët.<sup>129</sup>

## Sulmet dhe ngacnimet jofizike

Gjatë vitit 2021 ndodhën 13 raste të kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike ndaj gazetarëve në Kosovë. Kërcënimet dhe sulmet dallojnë mes atyre të afaristëve ndaj gazetarëve dhe punëtorëve të tjerë medial prej atyre të zyrtarëve shtetërorë si dhe të zyrtarëve të lartë të partive politike. Gazetari Mentor Gjergjaj, i cili pas një urdhëri të Prokurorisë Themelore në Gjakovë u ftua për t'u paraqitur në Stacioni Policor në Gjakovë për t'u intervistuar për një rast në lidhje me një artikull të publikuar nga gazetari më 3 maj 2018, në gazetën elektronike "Gazeta Express"<sup>130</sup> Ndërsa Parim Olluri nga Gazeta Insajderi u intervistua nga Policia e Kosovës, pasi Gazeta Insajderi e publikoi një hetim që përmbante informata të brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me refuzimin e vaksinave Pfizer dhe BioNtech nga kjo Ministri.<sup>131</sup> Dy raste të qasjes selektive ndodhën gjatë vitit 2021 ndaj gazetarëve të Kosovës, i pari ndodhi në Shqipëri, gjatë takimit të Kryeministrit shqiptar Edi Rama me Kancelaren gjermane Angela Merkel, ku gazetarët kosovarë u diskriminuan dhe nuk u lejuan të bënin pyetje<sup>132</sup>; ndërsa rasti i dytë ndodhi në Beograd, ku Adriatik Kelmendi u mor në pyetje nga BIA pas arrijtes së tij në territorin serb<sup>133</sup> dhe jo për herë të parë. Ndërkohë, zyrtarët e PK-së u përfshinë në dy raste të kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike të raportuara gjatë vitit 2021. Zyrtarët e PK-së u gjobitën dhe u penguan derisa ishin në detyrë dy ekipe të Klan Kosovës dhe TV Dukagjinit, në rajonin e Prishtinës-Gjilanit, përderisa po përpiqeshin të raportonin lidhur me një grabit-

je që kishte ndodhur atje.<sup>134</sup> Ndërsa rasti i dytë, ishte ai i Albion Muhaxhirit i portalit Indeksonline, kur u mor në pyetje nga policia në Kaçanik për shkak të një komenti në Facebook.<sup>135</sup> Hysamedin Feraj i VV<sup>136</sup>, si dhe dega e LDK-së në Suharekë përdorën poashtu gjuhë linçuese ndaj gazetarëve,<sup>137</sup> ndërsa grupi në Facebook #MeKryeministrin ka vazhduar me gjuhën denigruese ndaj gazetarëve dhe mediave.<sup>138</sup>

## Kërcënimet për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve

Janë dhjetë raste të kërcënimeve për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve. Shumica e rasteve të raportuara janë nga qytetarët, kryesisht që kanë të bëjnë me personat për të cilët kanë raportuar media të caktuara. Gazetarët e Gazetës Sinjali janë kërcënuar nga familjarët e një grupi personash të arrestuar për komplete për terrorizëm,<sup>139</sup> Bujar Vitija i Gazetës Shneta është kërcënuar nga një familjar i anesteziologut për të cilin kishte raportuar portali i lartpërmendur se është gjobitur nga Inspektorati Shëndetësor për faktin se është larguar nga vendi i punës gjatë ndërrimit të kujdestarisë,<sup>140</sup> ndërsa Idriz Morina, si dhe familja e tij morën kërcënime me vdekje përmes telefonit.<sup>141</sup> Deputeti i Vetëvendosjes, Haki Abazi e kërcënoi portalin "Albanian Post" dhe drejtorin e tij Baton Haxhiu lidhur me disa raportime të kaluara për dështimin e caktimit të ambasadorëve të rinj të Kosovës,<sup>142</sup> ndërsa këshilltari i Presidentes, Blerim Vela, përdori gjuhë denigruese ndaj mediave.<sup>143</sup> Të gjitha rastet e kërcënimeve ndaj gazetarëve gjatë vitit 2021 janë nën hetim të policisë.

## Numri i sulmeve fizike

Gjatë vitit 2021 ndodhën gjithsej tri sulme fizike ndaj gazetarëve. I pari ndodhi në shkurt 2021, kur gazetari

129 Dafina Lata, "Sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve janë sulm ndaj lirisë së fjalës", i qasur më 15.4.2022. <https://bit.ly/3sZHp8>

130 AGK, "Mentor Gjergjaj ftohet për intervistim në cilësinë e të dyshuarit", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3MIWegm>

131 AGK, "Pengim në detyrë Parim Olluri", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3tO3IOA>

132 AGK, "Qasje Selektive Ndaj Gazetarëve Kosovarë", i qasur më 12.02.2022. <https://bit.ly/3zacH3k>

133 AGK, "AGK E Dënon Sjelljen E BIA-S Serbe Ndaj Gazetarit Adriatik Kelmendi, E Fton Be-Në Të Reagojë", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3wUz4Hy>

134 AGK, "Pengim Në Detyrë Ndaj Ekspit Të Klan Kosovës Dhe Rtv Dukagjinit", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3wSllzK>

135 AGK, "Kërcënime Të Tjera Ndaj Gazetarit Alban Muhaxheri", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3PL6iSh>

136 AGK, "AGK E Dënon Gjuhën Kërcënuese Të Hysamedin Feraj Ndaj Gazetarëve", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3Nzhqjs>

137 AGK, "Agk I Dënon Linçimet E Degës Së Ldk-Së Në Suharekë Ndaj Gazetarit Journalist Uran Haxha", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3wPM80N>

138 AGK, "AGK E Dënon Gjuhën Denigruese Të Grupit Në Facebook #MeKryeministrin Ndaj Gazetarëve", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/38rXmjW>

139 AGK, "Kërcënim Ndaj Gazetarëve Të Gazetës Sinjali", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/39ZxCeW>

140 AGK, "Kërcënim Ndaj Gazetarit Bujar Vitija", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3MSJ7ni/>

141 AGK, "Kryeredaktori I "Bota Sot", Idriz Morina, E Paraqet Kërcënimin Në Polici", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3a0apcA>

142 AGK, "Kërcënime Ndaj 'Albanian Post'", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3zadm5m>

143 AGK, "AGK: E Papranueshme Gjuha Ndaj Mediave E Këshilltarit Të Presidentes, Blerim Vela", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3PLVSBN>

Visar Duriqi u sulmua fizikisht nga persona të panjohur pranë banesës së tij në mesnatë.<sup>144</sup> Kjo nuk ishte hera e parë që Duriqi u kërcënua për shkak të temave që i mbulon, megjithatë ishte hera e parë që u sulmua fizikisht. Ndërkohë, dy rastet e tjera ndodhën në Mitrovicën e Veriut, ku gazetarët shqiptarë dhe serbë u sulmuan nga protestuesit në rrugë,<sup>145</sup> si dhe Albulena Rexha e Kanalit 10 u gjuajt me mjete piroteknike gjatë raportit nga e njëjta ngjarje.<sup>146</sup>

### Numri dhe llojet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj institucioneve të mediave, organizatave dhe asociacioneve të mediave dhe gazetarëve.

Në bazën e të dhënave të AGK-së gjatë vitit të kaluar u regjistruan tre raste si kërcënime dhe sulme ndaj institucioneve, organizatave mediale, mediave dhe asociacioneve të gazetarëve. Rasti i parë ndodhi në fund të janarit, gjatë fushatës për zgjedhjet qendrore. Partitë politike, PDK dhe LDK përdorën gjuhë denigruese ndaj TV Dukagjinit.<sup>147</sup> Pastaj, dega e Lëvizjes Vetëvendosje në Mitrovicë e kërcënoi dhe e bojkotoi portalin lokal "JEPI ZË".<sup>148</sup> Ndërsa, kamera dhe taksi i ekipit të Radios Evropa e Lirë u dëmtuan nga një grup prej 50 personash, të cilët e penguan ekipin nga raportimi nga trazirat në Mitrovicën e Veriut.<sup>149</sup>

## **C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe akterëve politikë lidhur me mbrojtjen e gazetarëve**

A ka dispozita specifike në ligjet ose mekanizmat e tjerë që e mbështesin sigurinë e gazetarëve, si në terren (offline) ashtu edhe online?

Ekzistojnë dispozita ligjore, si ajo e Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në fuqi nga 14 prilli 2019) që e mbrojnë çdo person i cili mund të jetë viktimë e veprave penale për shkak të punës së tij/saj. Ekziston edhe Ligji

Nr. 04 / L-137 për Mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, i datës 31 korrik 2013.<sup>150</sup> Sidoqoftë, nuk janë hartuar politika të veçanta apo mekanizma të tjerë nga institucionet shtetërore për ta mbrojtur sigurinë e gazetarëve në veçanti. Sa i përket sigurisë së gazetarëve, Prokurorët dhe Gjykata Themelore në Prishtinë poashtu kanë caktuar koordinatoret për mbledhjen e të dhënave në rastet që përfshijnë gazetarët në vitin 2020 por përkundër kësaj, përpunimi i rasteve mbetet i ngadalshëm, gjë që krijon pakënaqësi në institucionet e drejtësisë në Kosovë.

A ka dokumente (protokolle, rregullore të punës, etj.) që janë miratuar nga institucionet shtetërore të cilat u japin udhëzime shtesë ushtrisë dhe policisë se si të sillen me gazetarë?

Policia e Kosovës (PK) ka caktuar një Koordinator që i monitoron dhe përcjellë të gjitha rastet që përfshijnë gazetarët. Të gjitha veprimet e marra nga ky institucion i sigurisë realizohen në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me organet tjera kompetente. Nuk ka procedura standarde të operimit brenda Policisë apo Prokurorisë lidhur me mbrojtjen e gazetarëve në rastet kur janë objekt i veprave penale apo frikësimit.<sup>151</sup>

A ka ndonjë mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e kërcënimeve, ngacmimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve dhe mosdëshkueshmërinë?

Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve i raportohen AGK-së, e cila avokon në emër të tyre, si dhe Policia dhe Prokuroria të cilat marrin masat e nevojshme për hetimin e këtyre rasteve. Prej disa kohësh, sistemi gjyqësor po kalon nëpër tranzicion përmes zhvillimit të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Rasteve (SMIR), i cili do t'i konsolidojë të dhënat dhe do të sigurojë përcjelljen e rasteve gjyqësore. Megjithatë, ende mbetet e paqartë nëse të dhënat nga policia do të konsolidohen në SMIR. Në anën tjetër, PK, bazuar në procedurat e brendshme të saj, raporton dhe publikon në baza ditore për të gjitha rastet, duke përfshirë ato që përfshijnë gazetarët. Megjithatë, digjitalizimi i bazës së të dhënave ka kohë që është në proces dhe pasi të përfundojë, do ta bëjë më të lehtë që të nxirren informata bazuar në profesionin e palëve në proces gjyqësor. Edhe pse zyrtarët

144 AGK, "AGK: Sulm Fizik Ndaj Gazetarit Visar Duriqi, Shqetësuese Dhe E Rrezikshme Për Lirinë E Shprehjes", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3asro7N>

145 AGK, "Sulmohen Gazetarët Shqiptarë E Serbë Në Veri Të Mitrovicës", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3PLbJR9>

146 AGK, "Sulm Ndaj Gazetares Albulena Rexha", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3z32R3p>

147 AGK, "Reagim Ndaj Fjalorit Linçues Të Pdk-Së Dhe Ldk-Së Ndaj Rtv Dukagjinit", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3LMDOhm>

148 AGK, "AGK E Dënon Bojkotin Dhe Fjalorin Linçues Ndaj Portalit "Jepi Zë" Nga Lëvizja Vetëvendosje Në Mitrovicë", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3wRPLV3>

149 AGK, "Sulm Ndaj Ekipit Të Rfe/RI", i qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3GrOk2I>

150 Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, intervista nga Getoarë Mulliqaj Bojaj, 12.2.2022.

151 Ehat Mihtaraj dhe Yll Zekaj, Përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi, intervista nga Getoarë Mulliqaj Bojaj, 15.02.2022.

nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës deklaruan në vitin 2019 që themelimi i SMIR do të bëhet si shpejt, ekspertët e medias dhe juristët e medias në Kosovë vlerësojnë ndryshe. Derisa të bëhet ndarja e rasteve të gazetarëve në Gjykatat e Kosovës, kushtet e punës dhe siguria e gazetarëve do të mbesin të paqëndrueshme dhe në rrezik.

**A njihen sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve nga institucionet shtetërore si shkelje e lirisë së shprehjes dhe ligjit penal? A japin zyrtarët qeveritarë deklarata të qarta duke i dënuar sulmet ndaj gazetarëve?**

Institucionet qeveritare i njohin sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve si cenim të lirisë së shprehjes, ligjit për të drejtat e njeriut dhe ligjit penal, por zyrtarët publikë përmbahen nga dhënia e deklaratave, vetëm nëse ka sulme fizike ndaj gazetarëve dhe/ose reagime nga asociacioni i gazetarëve, organizatat e shoqërisë civile apo vëzhguesit ndërkombëtarë të lirisë së mediave. Këto deklarata nuk janë pjesë e diskursit të tyre të përditshëm, por vetëm në rastet kur ndodhin këto sulme. Në deklaratat e tyre kërkojnë dënimin e autorëve, por nuk iu përgjigjen rasteve të gjuhës denigruese nga politikanët apo zyrtarët publikë/shtetëror.

**A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat e gazetarëve për çështjet e sigurisë së gazetarëve?**

AGK vepron në përputhje me PK-në për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me gazetarët që raportohen në PK. Për më tepër, AGK i inkurajon të gjithë gazetarët që t'i raportojnë rastet e tyre nga institucionet përkatëse dhe i monitoron ato raste rregullisht. Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes AGK-së dhe PK-së është shtyrë për vitin 2022. Kjo marrëveshje do të ndikonte drejtpërdrejtë në parandalimin e sulmeve ndaj gazetarëve si dhe në procedimin e rasteve.<sup>152</sup>

<sup>152</sup> MiM i hartuar dhe i ndarë me zyrën e PK-së për shtyp dhe informim publik. Memorandumi i Mirëkuptimit mes AGK-së dhe PK-së do të nënshkruhet sapo të qartësohet dokumenti nga zyrat ligjore të të dyja subjekteve.

**Në rastet e mbikëqyrjes elektronike, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësinë? Cili ishte rasti më i fundit i mbikëqyrjes elektronike mbi gazetarët?**

Para mbikëqyrjes elektronike duhet të sigurohet një urdhër nga gjykata, siç e lejon Kodi Penal<sup>153</sup> dhe Kodi i Procedurës Penale,<sup>154</sup> Ky urdhër jepet vetëm për raste të kërcënimit të lartë. Nuk ka asnjë rast të përgjimit elektronik të gazetarëve gjatë vitit 2021 në Kosovë. Megjithatë, sipas ekspertëve të sigurisë kibernetike të Kosovës, Kosova duhet të jetë e alarmuar kur bëhet fjalë për rrezikun e privatësisë së njerëzve, pasi sistemi kombëtar i mbikëqyrjes po krijohet.<sup>155</sup> Sipas Raportit të Progresit për Kosovën për vitin 2020 nga Komisioni Evropian, legjislacioni për krimet kibernetike në përgjithësi është në përputhje me atë të bashkësisë evropiane.<sup>156</sup>

### **C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve**

**A ka njësi specifike brenda institucioneve të sistemit të drejtësisë civile kushtuar hetimeve dhe ndjekjeve penale ndaj kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve?**

Në sistemin e drejtësisë në Kosovë nuk ka institucione/ njësi specifike të dedikuara për hetime, ndjekje penale, mbrojtje dhe kompensim për të siguruar sigurinë e gazetarëve dhe për ta adresuar çështjen e mosndëshkimit. Sa i përket sigurisë së gazetarëve, Prokuroria dhe Gjykata Themelore e Prishtinës kanë caktuar edhe koordinatore për mbledhjen e të dhënave për rastet e gazetarëve.<sup>157</sup> Roli i koordinatoreve brenda prokurorisë dhe gjykatave është kryesisht ta koordinojnë dhe mon-

<sup>153</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës "Kodi Penal i Republikës së Kosovës", qasur më 13.12.2021. <https://bit.ly/39UkvvH>

<sup>154</sup> Ibid.

<sup>155</sup> BalkanInsight "Kosovo Surveillance Build-up Raises Privacy Concerns", i qasur më 15.04.2022. <https://bit.ly/3Pl86ux>

<sup>156</sup> Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2021", Bruksel: 2020, i qasur më 15.4.2022. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/kosovo_report_2020.pdf)

<sup>157</sup> Koha.net, „Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar një koordinator për rastin e gazetarit”, qasur më 12.2.2022. <https://bit.ly/3M2GEWM>

itorojnë punën e prokurorëve në lidhje me rastet e tyre kundër gazetarëve.<sup>158</sup>

### **A ofrojnë Prokurori Publik dhe Ministria e Punëve të Brendshme burime të përshtatshme për t'i mbuluar hetimet mbi kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve?**

As Policia, as Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria apo Gjykatat nuk kanë në dokumentet e tyre strategjike asnjë objektiv apo aktivitet në lidhje me trajtimin e policisë, prokurorëve apo gjykatësve për trajtimin e rasteve ndaj gazetarëve. Sipas Institutit të Kosovës për Drejtësi, "Institucionet kosovare nuk ndajnë burime adekuate për t'i mbuluar hetimet dhe masat e mbrojtjes që u ofrohen gazetarëve janë të pamjaftueshme. Asnjë institucion nuk flet për rritjen e ndërgjegjësimit brenda tij për sigurinë e gazetarëve".<sup>159</sup>

### **A hetohen krimet kundër gazetarëve, përfshirë frikësimet dhe kërcënimet, me shpejtësi, të paanshme dhe me efikasitet? A ka masa të mbrojtjes që u ofrohen gazetarëve si reagim ndaj kërcënimeve për sigurinë e tyre fizike?**

PK është institucioni më efektiv sa i përket hetimeve të rasteve që përfshijnë kërcënime dhe dhunë ndaj gazetarëve.<sup>160</sup> Rastet që kanë të bëjnë me sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve mbulohehen përmes neneve të ligjeve të caktuara të cilat nuk specifikojnë profesionin e viktimës.<sup>161</sup> 23 nga 29 rastet që ndodhën gjatë vitit 2021 janë raportuar në polici, dy prej të cilave janë ende nën hetim, ndërsa për dy raste për të cilat AGK nuk është njoftuar pasi gazetarët kanë zgjedhur të mbesin anonimë dy persona janë marrë në mbajtje për 48 orë. Po ashtu, lidhur me rastin e kërcënimeve online ndaj Vehbi Kajtazit janë identifikuar dhe arrestuar dy persona të dyshuar dhe me vendim të prokurorit të rastit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje. Rastet e tjera janë referuar në Prokurori. Në të kaluarën, gazetarëve të kërcënuar iu është ofruar mbrojtje e afërt nga PK-ja.

Megjithëse Prokuroria e ka caktuar një Prokuror për monitorimin e rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe përkundër faktit se ekziston një bazë e të dhënave ku klasifikohen rastet e gazetarëve, këto raste zakonisht zgjaten dhe nuk hetohen men-

jëherë. Praktikrat e mëvonshme në lidhje me reagimin e institucioneve të tjera, përveç Policisë së Kosovës ndaj rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, dhe mos sigurimi i mbrojtjes së nevojshme të garantuar me ligj, i përkeqëson kushtet në të cilat gazetarët duhet ta bëjnë punën e tyre. Gjykatat nuk konsiderohen efikase për faktin se rastet nuk zgjidhen dhe zakonisht zgjaten, gazetarët pohojnë se hezitojnë t'i raportojnë të gjitha rastet.<sup>162</sup> Për shkak të vonësës në themelimin e SMIR-it, gjykatat nuk janë në gjendje t'i japin AGK-së të dhëna për rastet e gazetarëve. AGK njoftohet ose nga palët e përfshira në rast lidhur me gjendjen e rastit në gjykata, ose nga mediat. Si në rastin e Valon Sylës<sup>163</sup>, kur Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli aktgjykim ndaj të akuzuarit, për vepër penale, ku u shpall fajtor për këtë vepër penale dhe u gjosit me 4,500 (katër mijë e pesëqind) Euro. Edhe pse rastet që marrin vëmendje të madhe mediatike zakonisht merren më seriozisht dhe hetohen më shpejt, siç është rasti i ish-ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, i cili e sulmoi fizikisht një gazetar në vitin 2019<sup>164</sup> e njëjta nuk ndodhi kur Visar Duriqi u sulmua fizikisht në shkurt të vitit 2021, pasi që ende askush nuk është sjellur para drejtësisë.

Gjatë vitit 2021, Policia e Kosovës reagoi me kohë lidhur me rastet e dhunës dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Në disa raste, është ofruar edhe mbrojtje e afërt nga PK-ja për gazetarët kur rreziqet dhe kërcënimet ishin të rënda. Pavarësisht nga prokurorët e emëruar dhe bazat e veçanta të të dhënave të rasteve me kërcënime ndaj gazetarëve të krijuara tashmë në vitin 2020, situata me rastet kundër autorëve të këtyre veprave zgjatet procedura dhe shpesh duhen disa vite për të vazhduar. Situata ndryshon kur rastet marrin më shumë vëmendje mediatike.

### **Në rastet e aktgjyqimeve të formës së prerë, a imponohen sanksione vetëm për autorët e veprës apo edhe për nxitësit / ideatorët?**

Në rast se merret aktgjykim i formës së prerë, kryesisht dënimet shqiptohen vetëm për kryesit e veprave penale, pasi që në praktikë nuk ka raste kur dikush është dënuar për shkak të urdhërimit të veprës penale. Nga viti 2017 deri në vitin 2021 janë raportuar 115 raste të kërcënimeve, sulmeve, ngacmimeve dhe formave të tjera të presionit ndaj gazetarëve, por vetëm disa raste janë zbardhur. Besohet se vetëm në rastet e sulmeve fizike dhe/ose rasteve kur përfshihen politikanë (ras-

<sup>158</sup> Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj, Përfaqësues të Insitutit të Kosovës për Drejtësi, intervistuar nga Getoarëb Mulliqi Bojaj, 15.2.2022.

<sup>159</sup> Ibid.

<sup>160</sup> Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj, Përfaqësues të Insitutit të Kosovës për Drejtësi, intervistuar nga Getoarëb Mulliqi Bojaj, 15.2.2022.

<sup>161</sup> Besnik Ramosaj, Drejtor i Departamentit të Statistikave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, intervistuar nga Getoarëb Mulliqi Bojaj, 13.1.2021.

<sup>162</sup> Dy grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuese, OJQ-të dhe mediat elektronike të realizuara nga Getoarëb Mulliqi Bojaj më 10.1.2022 dhe 11.1.2022.

<sup>163</sup> Insajderi "Arrestohet sulmuesi i Valon Sylës", i qasur më 15.4.2022, <https://bit.ly/3LQKh1f>

<sup>164</sup> AGK, "Sulme fizike ndaj gazetarit, Ensar Ramadani, Prishtinë, 17.12.2019", i qasur më 14.4.2021, <https://bit.ly/3NATzj6>

Tabela 3: Pasqyrë e aktiviteteve të përfunduara për zgjidhjen e disa prej sulmeve më të rënda ndaj gazetarëve në pesë vitet e fundit

Rast	Vit	2017.	2018.	2019.	2020.	2021.
1. Sulm fizik ndaj Ensar Ramadanit (17.12.2019)				18.12.2019 – Prokurori i Shtetit nis hetimet për rastin. 10.02.2020 – Sulmuesi paditet për sulm nga Gjykata Themelore në Prishtinë.		
2. Kërcënime ndaj Bujar Vitijajt, reporter në portalin Shneta				08.10.2019 – Gjykata Themelore në Prishtinë e gjobit autorin e veprës me 200 Euro.		
3. Kërcënime ndaj Taulant Osmanit reporter i Kallxo.com (11.11.2017)	13.11.2017 – Gjykata Themelore në Gjiilan vendos urdhër ndalimi për M.N. për kërcënimin e gazetarit.					
4. Më 02.04.2019 një gazetar u kërcënua nga një imam në Pejë			-		Krimi raportohet Prokuroria e merr rastin Prokuroria e dërgon në gjykatë Gjykata e miraton kërkesën Gjykata nis masa hetuese	
5. Më 13.06.2020 i vihët zjarri veturës së Shkumbin Kajtazit.					22.03.2021 – Gjykata Themelore në Mitrovicë e akuzon autorin e veprës me 10 muaj burgim efektiv dhe 20 Euro për shpenzimet gjyqësore.	
6. Më 18.10.2020 vetura e Shkumbin Kajtazi sulmohet me armë zjarri.					Krimi raportohet Prokuroria e merr rastin Rasti është nën hetim	
7. Më 22.12.2020 gazetari Valon Syla u sulmua fizikisht.					Gjykata Themelore në Prishtinë shpall aktgjykim ndaj të akuzuarit, për veprën penale "Lëndim i lehtë trupor", nga neni 185 par.1, nënpar. 1.4 i Kodit nr. 06/L-074 të KPRK. I akuzuari shpallet fajtor për këtë veprë penale dhe gjobitet me 4,500 (katër mijë e pesëqind) Euro, të cilat duhet t'i paguajë 15 ditë pas aktgjykimit të formës së prerë. Koha e kaluar në paraburgim, nga 22.12.2020 deri më 06.01.2021, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.	
8. Më 25.02.2021 gazetari Visar Duriqi u sulmua fizikisht						Krimi raportohet Prokuroria e merr rastin Rasti është nën hetim



	Vit 2017.	2018.	2019.	2020.	2021.
<b>Rast</b>					
	8. Më 16.12.2021 gazetari Vehbi Kajtazi nga Paparaci.com mori kërcënime me vdekje në internet				Dy të dyshuar janë identifikuar dhe arrestuar, pasi që dyshohet se e kanë kërcënuar një gazetar në rrjetet sociale. Pas intervistës, me vendim të prokurorit të rastit, i dyshuari u dërgua në paraburgim.

ti i Ensar Ramadanit), autorët gjenden dhe sillen para drejtësisë, ndërsa për rastet e tjera zgjaten deri në atë masë ku gazetarët heqin dorë nga kërkimi i drejtësisë. Vlerësohet se gazetarët hezitojnë t'i raportojnë rastet e tyre nga institucionet përkatëse për faktin se ato raste zakonisht zgjaten ose nuk zgjidhen fare.

**A organizojnë institucionet trajnime të përshtatshme për policinë, prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe gazetarët? A i organizojnë ata këto trajnime në bashkëpunim me asociacionet e gazetarëve?**

Akademia e Drejtësisë gjatë tërë vitit organizon trajnime për prokurorët dhe gjykatësit për lirinë e shprehjes. IKD gjatë fazës së raportimit mbajti trajnime për avokatët, gjykatësit dhe prokurorët për lirinë e shprehjes, lirinë e medias, si dhe për të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.<sup>165</sup> PK ka organizuar trajnime në lidhje me mediat me pjesëmarrje të një numri zyrtarësh policorë, përmes të cilave i ka shtuar kapacitetet e brendshme për punë kompetente me mediat. Prokurorë dhe koordinatore të caktuar, zëdhënës, administratorë të prokurorive, bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë të tjerë, kanë marrë pjesë në trajnime për marrëdhëniet me mediat, të mbështetura kryesisht nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, megjithëse ka ende nevojë për trajnime të mëtejshme.<sup>166</sup>

<sup>165</sup> Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj, Përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 15.2.2022.

<sup>166</sup> Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 12.2.2022.

# Përfundimet dhe rekomandimet

## Përfundime

Ky studim kishte për qëllim ta hulumtonte shtrirjen e mediave sa i përket lirisë dhe sigurisë së gazetarëve në Kosovë dhe për të parë se a ofron konteksti socio-ekonomik dhe politik brenda vendit një mjedis të favorshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të medias në këtë aspekt. Raporti mbulon çështjet nga konteksti i vitit 2021 dhe bazohet në raportet e mëparshme të realizuara rreth kësaj teme nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës.

Gjetjet tregojnë që nuk është arritur progres, pasi që korniza ligjore konsiderohet mjaft gjithëpërfshirëse, sepse është e strukturuar edhe për ta mbështetur zhvillimin e sektorit të medias dhe gazetarët. Megjithatë, mbesin sfida sa i përket zbatimit të saj. Ekziston një përshtypje se financimi i TSHP RTK lë hapësirë për presion, pasi që nuk ka pasur forma të tjera që nga themelimi për financimin e tij. Organi rregullativ KPM dhe organi vetë-rregullativ KMSHK në përgjithësi konsiderohen si efektiv por zbatimi i mandatit të tyre sfidohet në mungesë të burimeve adekuate. Mekanizmat për mbledhjen e të dhënave për monitorimin adekuat dhe referimin e rasteve të shpifjes dhe fyerjes kanë mungesë të përcjelljes së duhur të efektivitetit të institucioneve gjyqësore për t'i regjistruar çështjet e ngritura para tyre. Kjo për shkak të mungesës së një mekanizmi të duhur, që do të vendoset përmes SMIR i cili do të funksionalizohet. SMIR do të mundësojë ndarjen dhe gjurmimin kronologjik të të dhënave.

Edhe pse gazetarëve iu garantohet e drejta e asociimit dhe liria për formimin e sindikatave, në Kosovë nuk ekziston një sindikatë gjithëpërfshirëse. Aktualisht, ekzistojnë tri

sindikata në kuadër të TSHP, ndërsa adresa e vetme e punëtorëve të mediave private për raportimin e shkeljeve nga punëdhënësi dhe palët e treta është AGK. Trendi i sulmeve verbale ndaj Asociacionit po rritet çdo vit, sidomos nga zyrtarët publikë, si dhe ndjekësit fanatikë të partive politike. Ekziston një dakordim mjaft i njëanshëm për kushtet e këqija ekonomike të gazetarëve, siç është mungesa e përgjithshme e kontratave ose kontratat afatshkurta, pagat e ulëta dhe pagesa e tyre e rrallë, kushtet e këqija të punës, për t'i përmendur vetëm disa si dhe përdorimi i këtyre kushteve për të ushtruar presion ndaj gazetarëve. Gazetarët janë shumë më pak të përfaqësuar në emisionet që shfaqen në kohën kryesore, si dhe në pozitat menaxheriale në redaksi. Presioni nga kuotat ditore rezultojnë në raportim të paverifikuar dhe përhapje të keqinformimit ndërsa, njëkohësisht, vetëcenzura konsiderohej si një nga ndikimet më të mëdha indirekte. Disa media private ende nuk kanë kod të mirësjelljes. Vetë pavarësia editoriale në disa nivele ndikohet nga vetë-cenzura. Përderisa gazetarët raportuan që janë të lire të zgjedhin storje, ata janë të vetëdijshëm për këndvështrimet që mund t'i paraqesë ajo storje.

Gjatë vitit 2021 pati rritje të numrit të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, numër i cili u rrit deri në 29 raste të raportuara. Në vitin 2019, u raportuan 21 raste, ndërsa në vitin 2020 24 raste. Megjithatë, rritja e raportimit mund të interpretohet si një hap drejt ndryshimit pozitiv pasi që gazetarët ndihen më të sigurtë për t'i raportuar rastet e kërcënimeve dhe sulmeve. Përderisa numri i sulmeve të raportuara është rritur, studimi konstatoi që institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë ende iu mungojnë burimet e nevojshme për ta trajtuar situatën e gazetarëve në sistemet e gjykatave. Përkundër kësaj, përpjekjet për përmirësimin e situatës janë të qarta, pasi që është bërë caktimi i koordinatorëve për mbledhjen e të dhënave për rastet e gazetarëve nga Prokurorët dhe Gjykata Themelore e Prishtinës si dhe zhvillimi i SMIR-së që është në proces dhe do të mundësojë monitorimin, referimin, ndarjen dhe përcjelljen kronologjike të rasteve.

## Rekomandime

Legjislacioni i Mediave në përgjithësi – me hapësira për përmirësim – konsiderohet si gjithpërfshirës me shkathhtësitë e duhura për të mundësuar zhvillimin dhe funksionimin e sektorit të medias dhe mekanizmave të tij. Mjedisi që mundëson zbatimin e tij po dobësohet dhe duhet të përforcohet. Rekomandimet që kanë dalë nga gjetjet e studimit janë si në vijim:

## A. Rekomandimet ligjore dhe financiare

- Të sigurohet qëndrueshmëria ligjore dhe financiare e TSHP-së për ta shtuar paanësinë, për ta ulur ndikimin politik dhe për ta mbrojtur pavarësinë e tij në pajtim me statusin e tij.
- RTK-ja duhet të trajtohet si institucion publik dhe duhet të identifikohen metodat e duhura për financimin e tij, siç është prezantimi i një pagese që duhet të bëhet nga çdo ekonomi familjare. Praktikata e mira ndërkombëtare mund të përdoren si shembull.
- Të sigurohet llogaridhënia e TSHP-së për ta rritur paanësinë, për ta ulur ndikimin politik dhe për ta mbrojtur pavarësinë e tij në përputhje me statusin e tij.
- Paanshmëria politike duhet të përforcohet brenda RTK-së. Duhet të caktohet një formë tjetër e emërimit pasi që forma aktuale mbështetet vetëm në komisionin e emëruar nga Kuvendi i Kosovës dhe si e tillë i rritë mundësitë e subjektivitetit dhe ndikimit politik.
- Paanshmëria politike e Bordit të KPM-së dhe rritja e kompetencave të organit vetë-rregullativ: Emërimi i Bordit të KPM-së: duhet të rivlerësohet për t'i ulur rreziqet e subjektivitetit dhe ndikimit politik dhe duhet të vendosen rregulla më të ashpra për lidhjet politike të anëtarëve të bordit.
- Të rriten kompetencat e organit vetë-rregullativ KMSHK. Një aspekt i rëndësishëm që është relevant për ta rritur transparencën dhe për të siguruar llogaridhënie më të madhe të mediave është sigurimi i metodave për të kërkuar të dhëna nga mediat, siç është pronësia e mediave.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta finalizojë themelimin e SMIR sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe ta bëjë prioritet ndarjen e rasteve të padive të shpifjes ndaj gazetarëve.
- Duhet të themelohen mekanizmat e duhur në mënyrë që të mbështetet zbatimi i legjislacionit. Procesi i trajtimit të kërkesave për qasje në dokumente publike duhet të rishikohet dhe të përpilohen udhëzime të qarta që do të ndihmonin në këtë proces dhe në zbatimin e legjislacionit.

## B. Pozita e gazetarëve në redaksi

- Mediat duhet ta theksojnë përdorimin e Kodit të Etikës dhe ta promovojnë atë si kushtetutë për sjelljen e mediave për ta rritur raportimin cilësor dhe profesionalizimin e gazetarëve.
- Mediat duhet të inkurajohen ta zhvillojnë kodin e tyre të sjelljes ose ta miratojnë atë të organeve vetë-rregullative dhe të sigurojnë që janë vendosur mekanizmat e duhur brenda secilës media për të siguruar respektimin e tij.

- Mediat duhet të punojnë për të krijuar mekanizma për verifikim më të mirë të lajmeve, për ta përmbajtur përhapjen e informatave të gabuara, dezinformatave dhe lajmeve të rreme.
- Pronarët e mediave duhet të bëjnë të pamundurën për të siguruar pavarësi më të madhe editoriale nga të gjitha format e presionit ndaj gazetarëve dhe redaktorëve.
- Mediat duhet të kenë procedura dhe rregullore të mirëfillta si dhe komisione disiplinore të integruara brenda institucioneve të tyre për ta zvogëluar ndërhyrjen e pronarëve, menaxherëve të mediave dhe organeve politike dhe zingjiri hierarkik nuk duhet të jetë imun ndaj këtyre procedurave. Këto politika duhet të përcaktojnë qartë kufijtë editoriale dhe çfarë përbën ndërhyrje.
- Duhet të rritet respektimi i standardeve profesionale përmes miratimit të Kodit të Mirësjelljes. AGK së bashku me FEJ, UN Women, IKD, OSBE, KE dhe akterë të tjerë ndërkombëtarë dhe kombëtarë po zbatojnë trajnime për gazetarët mbi qasjet e duhura për raportimin e lajmeve.
- Të përforcohet pozita ekonomike e gazetarëve dhe themelimi i një Sindikate gjithëpërfshirëse.
- Rregullimi i procedurave të punësimit për gazetarët duhet të zhvillohet dhe zbatohet përmes Inspektoratit të Punës i cili do të kërkojë përmirësim të efikasitetit të tyre në trajtimin e shkeljeve të të drejtave të punës për gazetarët. Tutje, roli i Sindikatave

(tri sindikatave ekzistuese brenda TSHP-së si dhe i asaj që duhet të themelohet) duhet të forcohet dhe duhet të inkurajohen mjediset që mundësojnë zhvillimin e tyre brenda sektorit të mediave private për të siguruar kushte më të mira pune për gazetarët.

- AGK është duke i mbështetur gazetarët në kërkesat e tyre për kushte të përmirësuara të punës përmes avokimit, përfaqësimit në grupe punuese të parlamentit ku diskutohet legjislati i për mediat dhe do të vazhdojë t'i mbrojtë të drejtat e gazetarëve kur ato nuk respektohen.

### C. Siguria e gazetarëve

- Institucionet kosovare duhet të sigurojnë mjedis më të sigurtë për gazetarët në Kosovë duke ofruar mbrojtje më efektive për gazetarët.
- Pronarët e mediave duhet t'i japin prioritet sigurisë financiare për mirëqenien e gazetarëve
- Duhet të hartohen politika të veçanta që i mbrojnë gazetarët në veçanti
- Duhet të bëhet mbledhja e të dhënave për rastet e gazetarëve nga Gjykatat
- Duhet të themelohen njësi specifike brenda institucioneve të dedikuara për mbrojtjen e gazetarëve







